



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26 regjistër (JR)
Datë 20.05.2019

Nr. 12 i vendimit
Datë 06.07.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.07.2020, ditën e hënë, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia Roessing, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Pashk Gjaci, gjyqtar, me detyrë kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Pashk Gjaci.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës, nenet 1, 2, 63 e 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në

ankim dhe parashtrimet e tij, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Pashk Gjaci, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Pashk Gjaci (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit.

1.3 KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, më datë 22.02.2019, Komisioni vendosi të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: kontrollin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, dhe të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e këtij hetimi. Në zbatim të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me konstatimet e bëra gjatë hetimit administrativ.

3. Më datë 12.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka dërguar pranë Komisionit shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit të kryer nga ky institucion. Më datë 19.03.2019, në Komision, është zhvilluar seanca dëgjimore publike për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Pashk Gjaci, tek e cila ky i fundit ka qenë i pranishëm.
Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni shpalli për subjektin e rivlerësimit Pashk Gjaci vendimin nr. 116, datë 21.03.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 116, datë 21.03.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtar dhe kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë në pronësi apo posedim të tij dhe personave të tjerë të lidhur, në formularin e rivlerësimit, si dhe në deklaramet periodike vjetore, duke bërë deklaram të rremë.*
- *Subjekti nuk justifikoi me burime të ligjshme financiare pasuritë në pronësi të tij, nga ku rezultoi se ai ka pasuri më të madhe nga ajo që mund të justifikohet ligjërisht, por pasuria e tij nuk kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe se ajo është krijuar gjatë periudhës së ushtrimit të profesionit të avokatisë.*

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

- *Veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë proces janë të drejta, deklaramet e tij përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje. Nga vlerësimi në tërësi i dokumentacionit në dosje, si dhe të deklarameve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues krijoi bindjen se nuk ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhëna të mjaftueshme që mund të cenojnë figurën e gjyqtarit.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë gjen të pambështetur konkluzionin e grupit të punës së DSIK-së për subjektin e rivlerësimit Pashk Gjaci.*

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

- *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, dhe konsiderohet “i aftë”.*
- *Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “c”, e ligjit nr. 84/2016.*

4.4 Për denoncimet nga publiku:

Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit të cilat ishin në përputhje me dokumentacionin e administruar nga organet kompetente dhe, në përfundim, nuk gjeti indicie të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.

5. Komisioni, pas vlerësimit të çështjes në tërësi, si dhe bazuar në bindjen e brendshme, ka arritur në konkluzionin përfundimtar se: *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë për kriterin e pasurisë. Në zbatim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ai ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur dhe se me shpjegimet dhe provat e paraqitura ai nuk arriti të bindë trupin gjykues për të kundërtën, duke mos arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit Pashk Gjaci, më datë 08.05.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 116/1, datë 09.05.2019.
Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, bazuar në shkaqet si më poshtë.
7. Në lidhje me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar:
- 7.1 Komisioni, për çdo çështje për të cilën i ka kaluar barrën e provës, do të duhej të shprehej me vendim të ndërmjetëm në lidhje me pranimin ose jo të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.
- 7.2 Pavarësisht detyrimit të përcaktuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016 për marrjen e të dhënave nga institucionet dhe subjektet e treta, Komisioni nuk ka vepruar në këtë drejtim. Ky detyrim i Komisionit në kuadër të një procedure me natyrë publike, prevalon në raport me detyrimin e subjektit për të provuar të kundërtën e asaj që është konkluduar.
- 7.3 Në kundërshtim me detyrimin ligjor, Komisioni nuk e njohu subjektin e rivlerësimit me rezultatet e pritshme të procedurës administrative, për t'i bërë të njohura mangësitë që pretendonte se ekzistonin, para se të zhvillohej seanca dëgjimore publike, duke i mohuar kështu atij të drejtën e mbrojtjes, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNj").
- 7.4 Komisioni duhet të caktonte ekspertë të fushave përkatëse në lidhje me çfarë ka konstatuar, sepse referon në një analizë ekonomike të kryer nga specialistë të Komisionit, por kryerja e një vlerësimi të tillë teknik, kur subjekti i rivlerësimit është shprehur kundër dhe vetë Komisioni e ka pranuar arsyetimin e tij duke lëvizur nga vlerësimi fillestar, do të duhej të kryhej me një procedurë të rregullt gjykimi, gjë që nuk ka ndodhur.
- 7.5 Megjithëse subjekti i rivlerësimit ka qenë në pozita favorizuese për faktin se pronësitë mbi pasuritë i ka fituar para se të bëhej subjekt deklarues i pasurisë, Komisioni duke vepruar në kundërshtim me praktikën e ndjekur për subjektet e tjera në lidhje me pasaktësitë në deklarin, e ka vënë atë në pozita diskriminuese, duke shkelur nenin 18 të Kushtetutës, si dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni kështu ka cenuar besimin e subjektit të rivlerësimit për një gjykim të drejtë e të paanshëm, në shkelje të neneve 6 dhe 14 të KEDNj-së.
- 7.6 Vendimmarrja e Komisionit është jo e ligjshme, pasi në vendimin objekt ankimi nuk rezultojn të jetë argumentuar qartë lidhja shkakësore që duhet të ekzistonte ndërmjet konstatimeve të Komisionit në raport me shkaqet dhe kriteret e parashikuara shprehimisht nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Në pajtim me parimin e proporcionalitetit, në kushtet kur subjekti i kishte deklaruar saktë pasuritë e tij, Komisioni

duhet të vlerësonte në tërësi të gjithë përbërësit e rivlerësimit dhe të dispononte konfirmimin në detyrë dhe jo shkarkimin e subjektit.

8. Në lidhje me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar:

8.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratat periodike vjetore, ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m², por Komisioni ka arritur në konkluzionin e kundërt me një arsyetim kontradiktor dhe jologjik, duke njohur vetëm pasojën juridike të regjistrimit të pronës në regjistrin publik e duke mos njohur përmbylljen e aktmarrëveshjeve mes tij dhe babait e vëllait të tij.

8.2 Komisioni ka shkelur nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, duke refuzuar pa të drejtë kërkesën e subjektit për të thirrur si dëshmitar z. N.N., i cili përtej asaj që kishte deklaruar para noterit publik, do t'i qartësonte Komisionit momente të tjera të rëndësishme lidhur me pasurinë tokë arë, me sipërfaqe 3800 m².

8.3 Subjekti i rivlerësimit do të kishte referuar me prova mbi faktin se vëllai i tij ka poseduar një pjesë të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3800 m², para regjistrimit të saj në emër të subjektit nëse do të ishte vënë në dijeni nga Komisioni për nevojën e marrjes së të dhënave në lidhje me vëllain e tij.

8.4 Veprimet e kryera për ndërtimin e shtëpisë së banimit 3-katëshe në Laç, janë referuar në emër të subjektit të rivlerësimit, duke respektuar legjislacionin në fuqi, megjithëse kontributi i tij ka qenë në masën 33%, i barabartë me atë të babait dhe vëllait të tij. Kontributet e babait dhe të vëllait janë njohur nga subjekti i rivlerësimit dhe janë kompensuar prej tij sipas aktmarrëveshjeve të lidhura mes tyre me vullnet të lirë, të cilat janë deklaruar saktësisht në deklaratimet e pasurisë në vite dhe deklarimin e rivlerësimit, pa pasur si qëllim fshehjen apo deklarimin e rremë të kësaj pasurie.

8.5 Marzhi i fitimit të realizuar nga ushtrimi i profesionit të avokatit, i përlogaritur nga Komisioni, nuk ka bazë ligjore dhe nuk është rezultat i një analize shkencore. Nga aktet e administruara në dosjen e rivlerësimit, provohet se gjatë periudhës 2000-2010, subjekti i rivlerësimit ka paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit, prandaj Komisioni do të duhej të pranonte fitimin neto të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si një e dhënë e pandikuar nga faktorë të jashtëm, aq më tepër kur bëhet fjalë për një periudhë gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë zyrtar vetëdeklarues në ILDKPKI.

8.6 Komisioni, në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit nuk i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, dokumentacion ligjor për të provuar mundësitë financiare të vëllait të tij për të kontribuar në krijimin e pasurisë shtëpi banimi me 3 kate, në Laç. Për këtë arsye, ai nuk ka paraqitur dokumente dhe nuk ka dhënë shpjegime në Komision, në dobi të këtij hetimi. Komisioni kishte detyrimin ligjor t'i kalonte subjektit të rivlerësimit barrën e provës në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe të mos arrinte në përfundime pa përmbushur këtë detyrim ligjor.

8.7 Në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare që me të ardhurat nga profesioni i lirë i avokatit, të kryente një të tretën e investimit për ndërtimin e shtëpisë së banimit 3-katëshe, në Laç.

9. Në mbështetje të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh¹, të cilat ai ka kërkuar të shqyrtohen prej trupit gjykues të Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), pasi sipas tij ato provojnë pretendimet e ngritura në shkaqet e ankimit.

Këto akte renditen si në vijim.

- o Vërtetim i Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë i provincës italiane {***} dhe {***}, sipas të cilit z. Gj. GJ., vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka qenë anëtar i kësaj dhome që nga viti 2000 dhe ka paguar të gjitha detyrimet, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vërtetimi.

- o Certifikatë e gjendjes familjare e familjes Gj. GJ., lëshuar nga komuna {***}.

- o Certifikatë familjare e familjes së Gj. GJ. (kryefamiljar), lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Velipojë.

- o Fotografi e emërimit të një llogarie bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, në emër të Regjina ose N. GJ..

- o Formular aplikimi pranë ALUIZNI-t nga z. Gj. GJ., datë 03.12.2014, për legalizimin e një ndërtimi pa leje të kryer në vitin 2011, në fshatin {***}, Velipojë.

- o Kërkesë e z. Gj. GJ., drejtuar ZVRPP Shkodër, me objekt: “Përfundimin e procedurës administrative të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, në lidhje me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017, e noterit A. K., Zyra e Noterisë Shkodër”, si dhe formular aplikimi në ZVRPP Shkodër nga z. Gj. GJ., me numër kërkesë {***} e datë aplikimi 25.09.2017.

- o Faqja 1 dhe faqet 5-7 të formularit të deklarimit të pasurisë së rivlerësimit, si dhe faqet 1 dhe 3 të deklaratës periodike të interesave privatë të vitit 2017, të plotësuara nga subjekti i rivlerësimit.

- o Fotografi të dy pasurive në pronësi të subjektit të rivlerësimit, që ndodhen në Njësinë Administrative {***}, Bashkia Mirditë.

- o Fotografi të shtëpisë së banimit 3-katëshe në Laç, të ambienteve të saj të brendshme dhe të jashtme.

Subjekti i rivlerësimit, për të mbështetur pretendimet e tij, ka kërkuar gjithashtu thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. N.N. dhe z. Gj. GJ..

10. Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e tij të paraqitura para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj², ka paraqitur bashkëlidhur aktet si vijojnë.

- o Formular aplikimi pranë ALUIZNI-t, nga z. Gj. GJ., datë 03.12.2014, për legalizimin e një ndërtimi pa leje të kryer në vitin 2011, në fshatin {***}, Velipojë.

- o Fotografi e kodeve bankare dhe e një numri llogarie bankare në emër të znj. R. Gj..

- o Certifikatë e gjendjes familjare e familjes Gj. GJ., lëshuar nga komuna {***}.

- o Akte të Dhomës së Tregtisë, {***}, në gjuhën italiane.

- o Një akt në gjuhën gjermane.

- o Certifikatë për vërtetim pronësie, ZVRPP Shkodër, datë lëshimi e certifikatës 31.10.2019, e lëshuar për të vërtetuar që z. Gj. N. GJ. është pronar i pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1900 m², e shoqëruar me kartelën e pasurisë.

- o Vërtetim i Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë i provincës italiane {***} dhe {***}, sipas të cilit z. Gj. GJ., vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka qenë anëtar i kësaj dhome që

¹ Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur kërkesën me objekt: “Marrjen e provave të reja dhe/ose dëshmitarë, në lidhje me shqyrtimin e ankimit”.

² Subjekti i rivlerësimit, në vijim të ankimit, ka depozituar në Kolegj, më datë 26.06.2020, parashtrimet me shkrim lidhur me shkaqet e paraqitura në ankim. Bashkëlidhur këtyre parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “Kërkesë për përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit të çështjes nëpërmjet marrjes së provave të reja shkresore dhe/ose me dëshmitarë, në lidhje me ankimin kundër vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit”.

nga viti 2000 dhe ka respektuar përgatitjen e deklaratave të tatimit mbi të ardhurat, sipas modelit UNICO nga viti 2000-2017, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vërtetimi.

- o Librezë e kryerjes së pagesave të energjisë elektrike, CEZ shpërndarje ShA, qendra Shkodër, nr. i kontratës {***}, lëshuar z. Gj. GJ., kabina {***}, {***}, Shkodër fshat, NIPT privat.

- o Nxjerrje llogarie me nr. {***}, në lekë, Banka Raiffeisen, klienti Pashk Gjaci, datë printimi 11.06.2020, për periudhën 30.03.2009 - 31.12.2010.

- o “Vlerësim ekonomik për subjektin e rivlerësimit, z. Pashk Gjaci”, datë 23.06.2020, i hartuar nga P. Xh., kontabilist i miratuar.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

11. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve që ai i ka bashkëngjitur ankimit dhe kërkesën për marrjen e provave me dëshmitarë, si dhe të akteve të reja të depozituara në Kolegj me parashtrimet, 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore.
12. Trupi gjykues analizoi provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vlerësim të formës dhe përmbajtjes së pretenduar, në raport me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë moment procedural.
13. Trupi gjykues konstaton se disa prej provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit së bashku me ankimin, janë të njëjta me ato të paraqitura prej tij pranë Komisionit³, së bashku me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.
14. Analizën për pranueshmërinë për shqyrtim ose jo të provave të reja të paraqitura për herë të parë së bashku me ankimin, trupi gjykues e mbështet në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012), sipas të cilit: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

Trupi gjykues vlerëson se aktet e paraqitura nga subjekti bashkëlidhur ankimit, nuk mund të pranohen në cilësinë e provës nga Kolegji, pasi subjekti në ankim nuk ka provuar se ishte në pamundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cituar më sipër.

Megjithatë, trupi gjykues çmon të theksojë se edhe në prezumimin në favor të subjektit të rivlerësimit, se këto akte do të ishin në plotësim të kriterëve ligjore të sipërcituara, këto akte kanë mungesë vlere provuese për shkak të formës së tyre. Këto akte nuk plotësojnë kërkesat e neneve 251 dhe 266⁴ të Kodit të Procedurës Civile, për shkak se janë fotografi aktesh dhe nuk është vërtetuar njësia me origjinalin nga autoriteti kompetent. Në kërkesën e depozituar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me ankimin, për

³ Fotografitë e shtëpisë 3-katëshe të banimit në Laç, si dhe faqet e deklaratave të pasurisë të plotësuara nga subjekti i rivlerësimit, janë administruar nga Komisioni dhe janë pjesë e dosjes së procesit të rivlerësimit, e përcjellë nga Komisioni në Kolegj, për efekt të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

⁴ Neni 251 “Kopja e shkresës dhe origjinali i saj” i Kodit të Procedurës Civile, përcakton: “Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin”.

Neni 266 “Shkresa në gjuhë të huaj” i Kodit të Procedurës Civile, përcakton: “Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes”.

marrjen e këtyre provave, ai ka pranuar mungesën e paraqitjes së tyre në formën e kërkuar nga ligji, por është shprehur se do t'i paraqesë në formën e kërkuar nëse ato do t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor të ankimit nga trupi gjykues. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të neneve 47 dhe 49-51 të ligjit nr. 49/2012, momenti procedural për paraqitjen e provave të reja është momenti i paraqitjes së ankimit dhe ato duhet të paraqiten që në këtë moment në formën e kërkuar nga ligji. Për shkak të mungesës së formës së kërkuar nga ligji, për këto akte, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të shkronjës “c”, pika 6 e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, janë një mjet prove tërësisht i papërshtatshëm.

15. Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur bashkëlidhur me ankimin, për thirrjen si dëshmitar të vëllait të tij, z. Gj. GJ., për të provuar vullnetin e lirë të këtij të fundit për lidhjen para noterit publik të aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, kohën e posedimit të pasurisë tokë arë në Velipojë, si dhe burimin e të ardhurave të tij për kontributin e dhënë në ndërtimin e shtëpisë së banimit me tri kate në Laç, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, megjithëse i kishte të gjitha kushtet për ta paraqitur këtë kërkesë gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, po e paraqet për herë të parë në ankim. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar se ishte në pamundësi të paraqitjes së kësaj kërkesë që në fazën e hetimit administrativ, siç kërkon zbatimi i nenit 47 i ligjit nr. 49/2012.

Vullnetin e lirë për lidhjen e aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, z. Gj. GJ., vëllai i subjektit, e ka shprehur para noterit publik në momentin e lidhjes së saj dhe ky fakt i shprehjes së vullnetit nuk është vënë në dyshim në asnjë moment nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ. Për sa i përket momentit të disponimit të sipërfaqes prej 1900 m² nga vëllai i tij, në fshatin {***}, Velipojë, trupi gjykues vlerëson se vetëm dëshmia e z. Gj. GJ. nuk do të ishte e mjaftueshme për të provuar se ai e ka disponuar këtë sipërfaqe përpara lidhjes së kontratës së dhurimit. Në këto kushte, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se dëshmia e z. Gj. GJ. nuk është e nevojshme.

16. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur gjithashtu kërkesën për të thirrur si dëshmitar z. N.N., për të provuar kohën e likuidimit të shumës për blerjen e pasurisë tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, shkaku e vonës së regjistrimit të saj, momentin e posedimit të një pjese të kësaj prone nga z. Gj. GJ., si dhe kohën e fillimit të punimeve prej këtij të fundit për të kryer një ndërtim pa leje mbi këtë sipërfaqe toke, aktualisht në procedurë legalizimi. Trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur të njëjtën kërkesë për thirrjen si dëshmitar të z. N. N., kërkesë e cila është refuzuar nga Komisioni me vendimin e datës 15.03.2019. Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se është administruar deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, e z. N.N., në të cilën ka deklaruar se ai e zotëron sipërfaqen e tokës prej 4000 m² në fshatin {***}, mbi bazën e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, datë 05.03.2004, por kjo pasuri nuk ishte regjistruar ende në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se koha e likuidimit të shumës për blerjen e sipërfaqes tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, nga subjekti i rivlerësimit, gjendet e provuar nëpërmjet kësaj deklarate. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se z. N. do të provonte momentin e posedimit të një pjese të kësaj prone nga vëllai i subjektit dhe kohën e fillimit të punimeve prej këtij të fundit për të kryer një ndërtim pa leje, aktualisht në procedurë legalizimi, trupi gjykues vlerëson se kjo dëshmi nuk do të ishte e mjaftueshme për të provuar se z. Gj. GJ. ka poseduar pikërisht këtë sipërfaqe toke, pasi siç rezulton nga të dhënat e përcjella në Komision nga ZVRPP Shkodër, z. Gj. GJ. ka blerë nga z. N. dy sipërfaqe toke në fshatin {***}, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.09.2014 [vetëm një javë më vonë nga blerja e sipërfaqes prej 3800 m² nga subjekti i rivlerësimit]. Ndërsa koha e fillimit të punimeve të ndërtimit, për banesën e

pretenduar si të ndërtuar pa leje nga z. Gj. GJ., por aktualisht në proces legalizimi, dëshmia e z. N. nuk do të ishte e mjaftueshme, pasi koha e fillimit të punimeve të ndërtimit pa leje në proces legalizimi do të duhej të provohej nga të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit për efekt legalizimi, nga z. Gj. GJ.. Për të gjitha këto arsye, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se marrja e dëshmisë së z. N.N. është e panevojshme.

17. Për sa u përket provave të reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet para seancës gjyqësore, trupi gjykues vlerëson se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Fakti që këto prova janë paraqitur bashkëlidhur parashtrimeve para seancës gjyqësore, i përjashton ato nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre në zgjidhjen e çështjes.
18. Në Kolegj është paraqitur më datë 04.12.2019, një denoncim për subjektin e rivlerësimit nga znj. M. J.. Pasi vlerësoi këtë denoncim sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi mosfillimin e hetimit kryesisht për këtë denoncim, pasi nuk përmbante informacione të mjaftueshme për t’u hetuar.
19. Nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues çmon se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e palëve, është i panevojshëm në vlerësim të kriterëve të parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, pasi: a) vlerësohet se konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e prova të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk vlerësohet se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision. Për të gjitha arsyet e analizuara si më sipër, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet procedurale të ankimit për procesin e rregullt ligjor

20. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni, për çdo çështje për të cilën i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, do të duhej të shprehej me vendim të ndërmjetëm në lidhje me pranimin ose jo të provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, nga tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, konstaton se më datë 12.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka dërguar në Komision shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni mbi gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit administrativ. Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti ka paraqitur dhe aktin me lëndë: “Kërkesë për marrje të provave të reja shkresore/dëshmitarë, në lidhje me hetimin administrativ dhe procedurën e rivlerësimit”, në të cilën ka kërkuar që Komisioni të marrë në cilësinë e provës një sërë aktesh të paraqitura prej tij bashkëlidhur shpjegimeve mbi hetimin administrativ, si dhe ka kërkuar që të thirren si dëshmitarë z. N. N., z. P. N. dhe z. Gj. P.. Në përgjigje të kësaj kërkesë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka marrë vendimin e datës 15.03.2019, me të cilin ka vendosur të pranojë kërkesën në lidhje me provat që nuk ndodheshin në dosjen e rivlerësimit dhe t’i administrojë ato⁵, si dhe të refuzojë kërkesën për thirrjen si dëshmitarë të

⁵ Pika 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit, të datës 15.03.2019.

personave të kërkuar nga subjekti⁶. Komisioni ka arsyetuar mbi shkaqet e refuzimit të kërkesës për marrjen e provës me dëshmitarë, duke i çmuar si të panevojshme dëshmitë e kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, në bazë të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka konfirmuar njohjen me këtë vendim nëpërmjet postës elektronike, më datë 17.03.2019. Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore publike të datës 19.03.2019, subjekti nuk ka kundërshtuar asnjë element procedural të procedurës së hetimit të zhvilluar ndaj tij, në lidhje me marrjen e provave shkresore apo me dëshmitarë.

21. Nga verifikimi si më sipër i hapave proceduralë të ndjekur nga Komisioni, në lidhje me pranimin dhe refuzimin e marrjes së provave të kërkuara nga subjekti, në vlerësimin e trupit gjykues, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni është shprehur me vendim në lidhje me pranimin ose jo të provave të paraqitura prej tij, për rrjedhojë, subjektit i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.
Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se ai gjendet i pabazuar.
22. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *pavarësisht detyrimit të përcaktuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016 për marrjen e të dhënave nga institucionet dhe subjektet e treta, Komisioni nuk ka vepruar në këtë drejtim, edhe pse ky detyrim i Komisionit në kuadër të një procedure me natyrë publike, prevalon në raport me detyrimin e subjektit për të provuar të kundërtën e asaj që është konkluduar*, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer në Komision, konstaton se pas marrjes së vendimit nr. 1, datë 21.3.2018, për nisjen e hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar informacion për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nga institucionet publike⁷ dhe nga institucione private⁸. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si dhe i ka bërë të njohura provat dhe faktet e mbledhura, mbi të cilat ka mbështetur gjetjet e rezultuara.
23. Në seancën dëgjimore publike të datës 19.03.2019, subjekti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale në drejtim të riçeljes së hetimit administrativ për marrjen e ndonjë prove të re⁹, në kuadër të ndonjë konstatimi për hetim të mangët nga ana e Komisionit.
Në vendim, Komisioni ka shpjeguar se, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke renditur gjithë dokumentacionin e marrë në analizë¹⁰.
Mbështetur në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, ka kryer hetimin administrativ dhe ka mbledhur të gjitha provat e nevojshme për të arritur në rezultatet e konkluduara, për të cilat më pas i ka kaluar subjektit barrën e provës.
24. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se detyrimi i Komisionit për marrjen e të dhënave nga institucionet dhe subjektet e treta, në kuadër të një procedure me natyrë publike, prevalon në raport me detyrimin e subjektit për të provuar të kundërtën e asaj që është konkluduar, trupi gjykues vlerëson se pikat 3, 4 dhe 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 49 e 50 të ligjit nr. 84/2016 janë

⁶ Pika 2 e dispozitivit të vendimit të Komisionit, të datës 15.03.2019.

⁷ Komisioni, në funksion të hetimit administrativ, ka kërkuar informacione nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Ministria e Drejtësisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA, ALUIZNI etj.

⁸ Komisioni, në funksion të hetimit administrativ, ka kërkuar informacione nga bankat e nivelit të dytë dhe nga Universiteti Europian i Tiranës.

⁹ Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 19.03.2019.

¹⁰ Sipas paragrafit 12 të vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit.

shprehur qartë në lidhje me kompetencën e organeve të rivlerësimit për të mbledhur çdo informacion të nevojshëm e të dobishëm, në drejtim të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me kontrollin dhe verifikimin e deklaratave të subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit. Kjo kompetencë ushtrohet deri në momentin që Komisioni, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë. Në këtë moment të rëndësishëm procedural, Komisioni vendos mbylljen e hetimit administrativ dhe i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Në procesin e rivlerësimit, barra e provës është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim. Vlerësimi i shpjegimeve, fakteve e provave të paraqitura nga subjekti në përgjigje të barrës së provës, është pjesë e arsyetimit në vendimin përfundimtar të Komisionit. Për këto arsye, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se detyrimi i Komisionit për mbledhjen e të dhënave prevalon mbi detyrimin e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, nuk qëndron. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi është i pabazuar në ligj.

25. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni, në kundërshtim me detyrimin ligjor, nuk e njohu subjektin e rivlerësimit me rezultatet e pritshme të procedurës administrative për t'i bërë të njohura mangësitë që pretendonte se ekzistonin, para se të zhvillohej seanca dëgjimore publike, duke i mohuar kështu atij të drejtën e mbrojtjes, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së*, trupi gjykues çmon se procedura e rivlerësimit është e përcaktuar plotësisht në ligjin e posaçëm nr. 84/2016, në kreun VII, nenet 45-61 të tij, me referencat përkatëse në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë kësaj procedure. Procedura e rivlerësimit e parashikuar nga ligji nr. 84/2016 ka elemente të konsiderueshme ngjashmërie me procedurën administrative të parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative. Në verifikim të zbatimit të këtyre dispozitave në rastin konkret, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstaton se menjëherë pas hedhjes së shortit më datë 15.3.2018 dhe caktimit të trupit gjykues përkatës, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja. Me vendimin nr. 1, datë 21.03.2018, është caktuar kryesuesi i trupit gjykues, është deklaruar në lidhje me mungesën e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe është vendosur fillimi i hetimit administrativ. Subjekti është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit dhe ai ka deklaruar se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues. Me vendimin nr. 2, datë 22.02.2019, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit dhe ta njoftojë atë mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në rezultatet e hetimit administrativ, të cilat përmbajnë rezultatin e pritshëm të hetimit, për çdo gjetje është shprehur qartë se në cilat prova është bazuar Komisioni, duke i cituar ato. Për çdo gjetje, rezultatet e hetimit përmbajnë analizën e provave dhe, sipas rastit, edhe analizën financiare.
26. Subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen¹¹ dhe ka marrë dhe një kopje të saj, fakt të cilin e ka konfirmuar edhe në seancën dëgjimore. Më datë 12.03.2019, ai ka paraqitur shpjegime dhe prova pas

¹¹ Subjekti i rivlerësimit, më datë 27.02.2019, ka nënshkruar aktin "Deklaratë", në të cilin deklaroi se është njohur me të gjithë dokumentacionin e dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, në formë fizike dhe elektronike, si dhe ka marrë të gjitha aktet e kërkuara nga ai.

kalimit të barrës së provës mbi rezultatet e hetimit të Komisionit. Me vendimin e datës 15.03.2019, provat e paraqitura nga subjekti u pranuan nga Komisioni. Me të njëjtin vendim, Komisioni refuzoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e tre dëshmitarëve, mbështetur në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi i çmoi si të panevojshme këto dëshmi. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, e cila është zhvilluar më datë 19.3.2019. Në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit, si dhe iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, duke shpjeguar të gjitha momentet që ai i ka konsideruar të nevojshme për mbrojtjen e tij. Bazuar në procesverbalin e seancës së datës 19.03.2019, subjekti nuk ka shprehur asnjë kërkesë procedurale në drejtim të kërimit të rezultateve të pritshme të hetimit administrativ, por përkundrazi ka pranuar rezultatet e prezantuara nga relatorja e çështjes në Komision dhe ka dhënë shpjegime lidhur me to.

Në analizë të kësaj situate faktike, trupi gjykues vlerëson se Komisioni e ka njohur subjektin e rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ dhe atij i janë garantuar të gjitha të drejtat e parashikuara nga ligji nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

27. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu se me paraqitjen prej tij të provave dhe shpjegimeve të kërkuara nga Komisioni, ezaurohet barra e provës që parashikon ligji dhe më tej barra e provës i kalon Komisionit për të marrë prova të reja, të cilat do të rrëzonin pretendimet e subjektit. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, në kuptim të neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016¹², pasi Komisioni ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti dhe i ka vlerësuar drejt ato. Pas njohjes së subjektit me rezultatet paraprake të hetimit, atij i është dhënë e drejta që të paraqesë prova dhe shpjegime dhe, më pas, gjatë seancës dëgjimore, subjektit i është dhënë mundësia që të dëgjohet lidhur me çdo element të procesit të rivlerësimit, që ai ka gjykuar të arsyeshëm. Nuk është detyrim i Komisionit që të japë vlerësime paraprake për vlerën provuese për secilën prej provave, pasi kjo do të ishte paragjyqese për procesin. Këtë vlerësim Komisioni e bën vetëm në vendimin përfundimtar.

Në përfundim të arsyetimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të gjitha të drejtat e parashikuara nga ligji për realizimin e një mbrojtjeje efektive, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së dhe parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit është i paargumentuar dhe i pabazuar.

28. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni duhet të caktonte ekspertë të fushave përkatëse për çfarë ka konstatuar, sepse referon në një analizë ekonomike të kryer nga specialistë të Komisionit, por kryerja e një vlerësimi të tillë teknik, kur subjekti i rivlerësimit është shprehur kundër dhe vetë Komisioni e ka pranuar arsyetimin e tij duke lëvizur nga vlerësimi fillestar, do të duhej të kryhej me një procedurë të rregullt gjykimi, gjë që nuk ka ndodhur*, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor, konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me rezultatin e arritur nga analiza financiare se pasuritë e deklaruara prej tij në deklaratën e parafillimit të detyrës në vitin 2010, nuk përballoheshin me të ardhurat e deklaruara.

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar gjetjet e Komisionit, duke pretenduar se norma e fitimit nga aktiviteti i tij si avokat, nuk duhej të përlllogaritej

¹² Neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përcakton se: “Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.

nga Komisioni në masën 60% të qarkullimit vjetor, por duhej të përlloragitej rreth 90-95% e këtij qarkullimi.

Pas vlerësimit të të gjitha shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, Komisioni, në vendim¹³, ka arsyetuar se, nisur nga fakti që nuk ka një dokument zyrtar që konfirmon marzhin e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit si avokat nga subjekti i rivlerësimit për atë periudhë, si dhe mbi bazën e përgjigjes së marrë nga organi kompetent tatimor, fitimi i realizuar nga subjekti mund të llogaritej në masën 80% të vlerës së qarkullimit vjetor, pasi nga ky qarkullim duhet të zbriten tatimet dhe taksat e paguara, detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit, si: qira, shërbimet utilitare e shpenzime të tjera të nevojshme. Komisioni ka arritur në konkluzionin se pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parafillimit të detyrës të vitit 2010, nuk përballoheshin me të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, pasi ato nuk ishin të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për ndërtimin e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç.

Bazuar në situatën faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka pranuar shpjegimet e tij duke lëvizur nga vlerësimi fillestar, nuk është i bazuar në dokumentacion. Komisioni ka marrë në konsideratë pjesërisht pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me fitimin e realizuar prej tij nga ushtrimi i profesionit të lirë të avokatisë për periudhën 2000-2010, pasi nga 60% në rezultatet e hetimit, në arsyetimin e bërë në vendim e ka përlloragitur atë në masën 80% të qarkullimit vjetor, por konkluzioni i arritur në rezultatet e hetimit administrativ, se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të krijuar pasurinë shtëpi banimi me tri kate në Laç, në pronësi të tij, mbetet i njëjtë edhe në vendim.

29. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet të caktonte ekspertë të fushave përkatëse në lidhje me çfarë ka konstatuar, sepse referon në një analizë ekonomike të kryer nga specialistë të punësuar pranë tij, trupi gjykues konstaton se është një pretendim që subjekti i rivlerësimit nuk e ka paraqitur gjatë zhvillimit të hetimit në Komision, në asnjë fazë të tij dhe as si kërkesë procedurale në seancën dëgjimore publike të datës 19.03.2019.

Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi organet e rivlerësimit janë organe kushtetuese me kompetenca të përcaktuara në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në Aneksin e saj. Në nenin 179/b, pika 5 përcaktohet se rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, duke parashikuar kështu kompetencën bazë, ekskluzive të Komisionit, që është kryerja e procesit të rivlerësimit.

Ligji nr. 84/2016 përcakton procedurat dhe garancitë e ushtrimit të kompetencave të organeve të rivlerësimit. Në nenin 4, pika 1, ky ligj përcakton se procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, ndërsa në nenin 45, pika 1, në drejtim të përcaktimit të rregullave të hetimit të çështjes, përcakton se organet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në këtë kuptim, procesi i rivlerësimit është kompetencë e Komisionit, që ai e ushtron nëpërmjet trupave gjykuese, të asistuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë. Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është një proces vlerësimi strikt financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Trupi gjykues vlerëson se Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur Komisionin me të gjitha

¹³ Shih paragrafët 72 dhe 73 të vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit.

kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se është i paargumentuar dhe i pabazuar.

30. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni ka cenuar besimin e subjektit të rivlerësimit për një gjykim të drejtë e të paanshëm, në shkelje të neneve 6 dhe 14 të KEDNj-së, pasi edhe pse subjekti i rivlerësimit ka qenë në pozita favorizuese për faktin se pronësitë mbi pasuritë i ka fituar para se të bëhej subjekt deklarues i pasurisë, Komisioni duke vepruar në kundërshtim me praktikën e ndjekur për subjektet e tjera në lidhje me pasaktësitë në deklaram, e ka vënë atë në pozita diskriminuese, duke shkelur nenin 18 të Kushtetutës, si dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues, duke analizuar këtë shkak ankimi në raport me legjislacionin e pretenduar prej subjektit të rivlerësimit si të shkelur nga ana e Komisionit, vëren se Komisioni nuk ka arritur në konkluzione diskriminuese ndaj subjektit të rivlerësimit, për shkaqe të tilla, si: gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, por ka çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbetet i paargumentuar, pasi ai nuk ka shpjeguar se mbi ç'bazë e ka diskriminuar Komisioni dhe pse konkluzioni i arritur prej tij në vendim, përbën diskriminim lidhur me njërin nga cilësitë e përhershme individuale të mbrojtura nga neni 14 i KEDNj-së.
31. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se ndjekja e një standardi të dyfishtë prej Komisionit për raste të ngjashme, ka cenuar besimin e tij për një gjykim të drejtë e të paanshëm, në shkelje të neneve 6 dhe 14 të KEDNj-së, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi. Për më tepër, cenimi i besimit të subjektit të rivlerësimit për një gjykim të drejtë, duhet të konstatohet gjatë zhvillimit të gjykimit, në lidhje me realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe jo për shkak të një vendimmarrje në disfavor të subjektit. Trupi gjykues, në rastin konkret, vlerësoi më sipër në këtë vendim¹⁴, se subjektit i janë siguruar të gjitha garancitë ligjore të një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së.
32. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu, se krahasuar me subjektet e tjera, ai ka qenë në pozita favorizuese, pasi pronësitë mbi pasuritë i ka fituar para vitit 2010, vit në të cilin është bërë subjekt deklarues i pasurisë pranë ILDKPKI-së. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, qëllimi i deklaramit dhe kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit është identifikimi i atyre që kanë në pronësi apo përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose i atyre që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me shtojcën nr. 2 të këtij ligji, sipas së cilës në rubrikën “Deklarimi i pasurive” kërkohet të deklarohen: “Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaramtës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim

¹⁴ Në paragrafin 27 të këtij vendimi.

nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur”.

33. Si pasojë e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të sipërpërmendura, subjektit të rivlerësimit i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi/bashkëpronësi, posedim ose në përdorim të tij apo të personave të lidhur me të. Kontrolli i pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personin/personat e lidhur me të fillon nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit dhe shtrihet edhe në deklaratimet e viteve të mëparshme, për të verifikuar saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë dhe interesave private. Në këtë kuptim, pasuria e personit/personave të lidhur bëhet objekt kontrolli, si rezultat i faktit të deklaramit të këtyre pasurive në pronësi, posedim apo përdorim të subjektit dhe personit të lidhur me të, në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, pavarësisht kohës se kur janë krijuar ato dhe cilësisë së subjektit të rivlerësimit në momentin e krijimit të tyre. Ky qëndrim është konfirmuar tashmë edhe në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës për vlerësimin e pasurisë, ligji nuk kufizon as kohën dhe as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre¹⁵.
34. Duke u kthyer në rastin konkret, kontrolli i pasurive të subjektit ka ardhur si rezultat i deklaramit të tyre nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si pasuri në pronësi të tij. Megjithatë, duke qenë se subjekti i rivlerësimit pretendimin e tij e ka lidhur me fitimin e pronësisë mbi pasuritë e konstestuar nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se edhe në këtë këndvështrim pretendimi i subjektit është i pabazuar, pasi në analizë të situatës faktike të konstatuar nga hetimi administrativ, ka rezultuar e provuar se për pasuritë për të cilat Komisioni ka arritur në konkluzione negative, subjekti i rivlerësimit e ka fituar titullin e pronësisë, përkatësisht, për pasurinë arë 3.800 m² më datë 29.08.2014, me lidhjen e kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., kurse për pasurinë shtëpi trekateshe në Laç, më datë 29.12.2011, me regjistrimin e saj në ZVRPP Kurbin, në emër të tij, pra, në kohën që ka qenë në detyrën e gjyqtarit dhe ka qenë zyrtar deklarues i interesave privatë pranë ILDKPKI-së. Në konkluzion, edhe për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se është i paargumentuar dhe i pabazuar.
35. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimmarrja e Komisionit është jo e ligjshme, pasi në vendimin objekt ankimi nuk rezulton të jetë argumentuar qartë lidhja shkakësore që duhet të ekzistonte ndërmjet konstatimeve të Komisionit në raport me shkaqet dhe kriteret e parashikuara shprehimisht nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016 dhe se në pajtim me parimin e proporcionalitetit, në kushtet kur subjekti i kishte deklaruar saktë pasuritë e tij, Komisioni duhet të vlerësonte në tërësi të gjithë përbërësit e rivlerësimit dhe të dispononte konfirmimin në detyrë dhe jo shkarkimin e tij*, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, në vlerësimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë, ka arritur në konkluzionet:
“I. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë në pronësi apo posedim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur, në formularin e pasurisë së rivlerësimit, si dhe deklaratimet periodike vjetore, duke bërë deklaram të rremë.
II. Subjekti nuk justifikoi me burime të ligjshme financiare pasuritë në pronësi të tij, nga ku rezultoi se ai ka pasuri më të madhe nga ajo që mund të justifikohet ligjërisht, por pasuria e tij nuk kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe se ajo është krijuar gjatë periudhës së ushtrimit të profesionit të avokatisë”.
- Ndërsa në konkluzionin përfundimtar, në vlerësimin e çështjes në tërësi, Komisioni ka konstatuar: “Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për kriterin e pasurisë. Në zbatim të pikës 5 të nenit D

¹⁵ Vendimi nr. 2/2019 (JR), datë 04.02.2019, i Kolegjit.

të Aneksit të Kushtetutës, ai ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur dhe se me shpjegimet dhe provat e paraqitura, ai nuk arriti të bindë trupin gjykues për të kundërtën, duke mos arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.”

36. Në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në parashtrimin e shkakut të ankimit ka paraqitur disa pretendime, të cilat janë analizuar në vijim.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk gjendet në kushtet e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, rrethanë e cila do të përbënte një shkak të ligjshëm për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, si dhe nga Komisioni nuk rezulton të jetë evidentuar dhe argumentuar në mënyrë të qartë lidhja shkakësore që duhet të ekzistonte ndërmjet konstatimeve të bëra në lidhje me vlerësimin e pasurive, në raport me shkaqet dhe kriteret e parashikuara shprehimisht nga neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se Komisioni ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni në konkluzionin e tij, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është shprehur në mënyrë të posaçme që subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në rrethanat e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme. Në kushtet kur Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi ka vlerësuar se gjendet në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se është i pabazuar pretendimi i subjektit se Komisioni duhet të argumentonte lidhjen shkakësore ndërmjet konstatimeve të bëra dhe kriterëve të parashikuara nga neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

37. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni në vendimmarrjen përfundimtare nuk ka argumentuar as lidhjen shkakësore që duhet të ekzistojë ndërmjet konstatimeve për pasuritë e tij dhe shkaqeve e kriterëve që parashikon neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 apo ato të pikës 5 të po këtij neni, trupi gjykues vëren se Komisioni ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin, bazuar në rrethanat e parashikuara në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe jo në ato të parashikuara nga pika 5 e po këtij neni.

Komisioni, megjithëse në vlerësimin e kriterit të pasurisë ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë në pronësi apo posedim të tij dhe personave të tjerë të lidhur, si dhe nuk justifikoi me burime të ligjshme financiare pasuritë në pronësi të tij, në konkluzionin përfundimtar në vlerësimin tërësor të çështjes, ka mbetur në konstatimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të rremë për kriterin e pasurisë dhe ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur. Arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni e ka lidhur me konstatimin se pasuria e subjektit nuk kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme të tij dhe se ajo është krijuar gjatë periudhës së ushtrimit të profesionit të avokatisë. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në konkluzionin përfundimtar, nuk duhet të kishte mbetur vetëm në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të rremë për kriterin e pasurisë dhe ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur, si elemente të deklaramit të pamjaftueshëm, pavarësisht se ky përfundim përbën shkak të ligjshëm për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e pasurive, e vlerësuar nga Komisioni në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, është gjithashtu, një nga elementet e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Neni D i Aneksit të Kushtetutës përcakton kriteret për vlerësimin e pasurisë. Secili prej paragrafëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, të lidhur me rrethanat sipas të cilave prezumohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Secila nga këto rrethana është projektuar në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61

të ligjit nr. 84/2016, duke e materializuar sanksionimin kushtetues me përcaktimin konkret të shkeljes, më konkretisht, në parashikimet e pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e pasurisë, duke prodhuar masa disiplinore të veçuara nga njëra-tjetra. Në vijim edhe të jurisprudencës së Kolegjit në këtë drejtim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se Komisioni duhet të kishite përfshirë në konkluzionin përfundimtar edhe mungesën e burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pasuritë në pronësi të tij.

38. Bazuar në arsyetimin e bërë më sipër, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, ka kundërshtuar përfundimin e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme financiare në krijimin e pasurive në pronësi të tij, trupi gjykues vlerëson të mbajë qëndrimin e tij në lidhje me këtë shkak ankimi në raport me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në harmoni me konkluzionin përfundimtar të arritur prej tij në vlerësimin tërësor të çështjes. Në konkluzion, edhe për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se është i paargumentuar dhe i pabazuar.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

39. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vendimin e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë për pasuritë e tij, vlerësimi i të cilave nga Komisioni ka ndikuar në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
40. Në lidhje me pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m², në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Tokë arë, sipërfaqja 3800 m² në fshatin {***}, Velipojë, Shkodër, blerë sipas deklaratës noteriale, datë 17.12.2010 dhe kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.08.2014. Referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.08.2015 dhe aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, zotëroj 50%. Vlera 1400.000 lekë. Pjesa në %: 100% (I + shtator 2015 në proces administrativ ndarjeje)”.
41. Në përfundim të procedurës administrative, pasi ka verifikuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në raport me dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, e ka pasqyruar këtë pasuri 100% në pronësi të tij, me gjithë pretendimin se e ka shkëmbyer atë që në vitin 2012 me vëllain dhe babain e tij, mbështetur në aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012. Komisioni ka konstatuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar ndryshime të kësaj prone në deklaratat periodike vjetore të interesave privatë dhe nuk ka deklaruar asnjëherë posedimin e pjesës prej 1900 m² nga vëllai i tij. Komisioni, në vendim¹⁶, në vlerësimin për këtë pasuri, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m² në fshatin {***}, Velipojë, Shkodër, pasi shpjegimet e tij, deklaratimet periodike vjetore dhe dokumentet e paraqitura, nuk pasqyruan saktësi dhe besueshmëri të deklarimeve të bëra në formularin e rivlerësimit.
42. Në kundërshtim të këtij arsyetimi dhe konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtitë e tij nëpërmjet pretendimeve, të analizuara si më poshtë.

¹⁶ *Shih faqen 5 të vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit.*

43. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m² në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratat periodike vjetore, por Komisioni ka arritur në konkluzionin e kundërt, duke njohur vetëm pasojën juridike të regjistrimit të pronës në regjistrin publik e duke mos njohur përmbylljen e aktmarrëveshjeve mes subjektit dhe babait e vëllait të tij, në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se arsyetimi i Komisionit është kontradiktor dhe jologjik, teksa pranon vërtetësinë e deklaratës noteriale datë 17.12.2010 të shitësit N.N., ndërsa nga ana tjetër njeh vetëm pasojën juridike të ardhur në momentin e regjistrimit të pronës në regjistrin publik.*
44. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, në këndvështrim të rrethanave të faktit në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se ato paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

44.1 Subjekti i rivlerësimit ka fituar pronësinë mbi pasurinë tokë arë, me sipërfaqe 3800 m², e ndodhur në {***}, Velipojë, Shkodër, në bazë të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.08.2014¹⁷. Këtë pasuri ai e ka blerë nga bashkëpronarët N., D. e P. N., për vlerën 1.400.000 lekë. Sipas paragrafit 4.2 të kontratës së shitblerjes, çmimi i shitjes është shlyer i plotë nga pala blerëse, jashtë zyrës noteriale, gjë e cila sipas citimit të palëve kontraktore: *vërtetohet me deklaratën noteriale paraprake nr. {***}, datë 17.12.2010, të bërë nga z. N. N., duke u bërë pra dhe likuidimet përkatëse përfundimtare që në atë kohë.*

Sipas certifikatës për vërtetim pronësie të ZVRPP Shkodër, e cila gjendet bashkëlidhur kontratës së shitblerjes, kjo pasuri është regjistruar në emër të bashkëpronarëve N., më datë 08.08.2014.

44.2 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010¹⁸, e referuar në kontratën e shitblerjes si më sipër, z. N. N. ka deklaruar se nga prona që ka marrë familja e tij me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, datë 05.03.2004, në fshatin {***}, i ka shitur z. Pashk Gjaci një sipërfaqe toke arë prej 4000 m², për shumën 1.400.000 lekë. Z. N. konfirmon marrjen e të gjithë shumës së mësipërme, ndërsa deklaron se kontrata e mirëfilltë e shitblerjes së pasurisë do të bëhet pas plotësimit të dokumenteve të pronësisë për gjithë zonën e Velipojës. Ai ka deklaruar gjithashtu se qëllimi i hartimit të kësaj deklarate noteriale është *për ta paraqitur blerësi në dikasterin e ILDKPKI-së.*

44.3 Në mbështetje të deklarimit të bërë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë ILDKPKI-së edhe aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, e hartuar mes palëve N. Gj., Pashk Gjaci dhe Gj. Gj., të cilët deklarojnë: “[...] Me kontributin tonë të përbashkët, secili me 1/3 pjesë, kemi ndërtuar një shtëpi banimi trekatëshe, me sipërfaqe 140 m², në qytetin Laç (Kodër {***}), shtëpi e cila ka filluar të ndërtohet që në vitin 1997 dhe ka përfunduar në fund të vitit 2011 dhe aktualisht është regjistruar në ZVRPP Kurbin. Unë, N. Gj., kam qenë pronar i truallit mbi të cilin është ndërtuar kjo shtëpi banimi, ndërsa financiarisht për ndërtimin e kësaj banese kanë kontribuar në pjesë të barabarta të dy djemtë e mi. [...] me marrëveshje private midis nesh kemi bërë ndarjen e pasurisë sonë të përbashkët si vijon. Unë, N. Gj., në këmbim të së njëjtës sipërfaqe toke prej 500 m² në fshatin {***} të blerë prej deklaruesit Pashk Gjaci, i kam këmbyer këtij të fundit truallin e banesës dhe, si pasojë, ky i fundit është bërë pronar i këtij trualli, i cili ka qenë kontributi im. Unë

¹⁷ Bashkëlidhur si dokumentacion justifikues i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.01.2017.

¹⁸ Bashkëlidhur si dokumentacion justifikues i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.01.2017.

deklaruesi Gj. GJ. deklaroj se kontributin tim financiar në këtë banesë e kam këmbyer me vëllain tim Pashk Gjaci me një sipërfaqe toke prej 1.100 m², pasuri kjo e ndodhur në fshatin {***} të komunës Velipojë, e blerë me kontributin e vet nga ana e vëllait tim Pashk Gjaci. Si pasojë e këtyre këmbimeve, ne deklaruesit, N. dhe Gj. GJ., deklarojmë se pronar i vetëm i banesës së bashku me truallin është deklaruesi Pashk Gjaci dhe familja e tij dhe, si pasojë, këta të fundit kanë bërë regjistrimin e kësaj pasurie në ZVRPP Kurbin, procedurë kjo e kryer me autorizim nga unë deklaruesi N. Gj. .

Unë deklaruesi Pashk Gjaci deklaroj se jam dakord me sa deklaruan deklaruesit e mësipërm, se u kam këmbyer këtyre të fundit pasurinë time të ndodhur në {***}, Velipojë, në këmbim të pjesëve të tyre takuese në banesën e sipërcituar. Deklaroj se pasuria që ndodhet në {***}, Velipojë është në proces regjistrimi, barrë e cila është marrë përsipër me aktin nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, nga shitësi N.N. dhe, me t'u regjistruar kjo pasuri, do të bëj në formën e duhur ligjore kalimet e pronësisë të pjesëve të sipërcituara përfituesve të tyre, deklaruesve të mësipërm. Ne deklaruesit e bëjmë këtë akt për të vërtetuar veprimet e mësipërme dhe për t'u përdorur nga secili prej nesh si dokument, në çdo institucion ku një dokument i tillë do të nevojitet”.

44.4 Gjatë hetimit administrativ në Komision¹⁹, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një deklaram tjetër të babait të tij, z. N. Gj. , me deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.08.2015, sipas të cilit: “Më datë 02.01.2012, kemi bërë së bashku me djemtë e mi, Pashk Gjaci dhe Gj. GJ., një marrëveshje mbi bazën e së cilës, djali im Pashk Gjaci në këmbim të truallit me sipërfaqe prej 500 m², mbi bazën e të cilit ka ngritur shtëpinë e tij të banimit në lagjen nr. {***}, Laç, do të më bënte kalimin në pronësinë time të së njëjtës sipërfaqe toke (500 m²) nga pasuria e tij, të cilën e ka të regjistruar në emër të tij [...]. Gjatë kësaj kohe, pra nga momenti i përpilimit të kësaj marrëveshjeje dhe deri më tani, djali tjetër Gj. GJ., me miratimin tim, si dhe me shpenzimet e veta, ka bërë rikonstruksionin e shtëpisë sime të banimit në fshatin {***}, {***}, Mirditë. Duke qenë se unë nuk kam të ardhura ta shpërblej këtë të fundit për punën e kryer më sipër, kam vendosur të heq dorë nga përfitimi i sipërfaqes prej 500 m² tokë në fshatin {***} dhe këtë sipërfaqe toke, djali tjetër Pashk Gjaci t'ia këmbëjë vëllait të tij Gj. GJ.”.

44.5 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në ZVRPP Shkodër²⁰, në emrin e tij pasurinë arë me sipërfaqe 3.800 m², me nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, e cila është ndarë në dy sipërfaqe të tjera prej 1.900 m² secila, të pasqyruara në kartelat e pasurive nr. {***}, vol. {***}, faqe {***} dhe nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, të regjistruara më datë 11.08.2015 dhe datë lëshimi certifikate 19.01.2017.

45. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës mbi fitimin e pronësisë dhe regjistrimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të përmbledhur: “Me shtetasin N.N. jam njohur në vitin 2005 dhe jam vënë në dijeni prej tij se në fshatin {***}, ka pasur pronë të trashëguar e përveç kësaj edhe të fituar me ligjin nr. 7501/1991, si tokë bujqësore, një pjesë të së cilës dëshironte ta shiste. [...] pasi kemi rënë dakord për sipërfaqen, për vendin e përcaktuar dhe vlerën, sipas çmimit të referencës së përcaktuar nga shteti, pavarësisht se akoma nuk ishte e regjistruar prona, që në vitin 2005 kam vendosur të blija 4.000 m² tokë [...]. [...] Ndodhi që unë u emërova në detyrën e gjyqtarit dhe për të deklaruar kryerjen e veprimit të kalimit të pronësisë mbi sipërfaqen e tokës që kisha paguar, kam kërkuar që të hartohet deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, përsëri në pritje të regjistrimit fillimisht të pasurisë në emër të familjes bujqësore dhe pastaj ndarjen e saj në pjesë, nga e cila do të më kalonte mua pjesa për të cilën kisha kryer pagesën, duke e

¹⁹ Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, të paraqitura nga subjekti në Komision, më datë 12.03.2018.

²⁰ Sipas informacionit të përcjellë nga ZVRPP Shkodër në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2018.

zotëruar fizikisht [...]. Në lidhje me burimin e financimit për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, deklaroj se të ardhurat janë realizuar nga puna si avokat dhe kursimet ndër vite. Pagesa nuk është bërë e menjëhershme, ajo ka filluar në vitin 2005 e ka përfunduar para vitit 2010 kur unë kam filluar detyrën e gjyqtarit, e pasqyruar kjo në deklaratën noteriale të lëshuar nga shitësi, akti datë 17.12.2010. [...] në bazë të kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017, është bërë kalimi i pasurisë nr. {***} në favor të pronarit të ligjshëm, vëllait tim Gj. GJ., pavarësisht se deri tani nuk është regjistruar kjo pasuri në emër të tij, për faj të ZVRPP Shkodër, sepse aplikimin, me sa kam dijeni, e ka bërë ditën e ndarjes së pasurisë dhe lidhjes së kontratës së dhurimit”.

46. Për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij në lidhje me dhurimin e një pjese të pasurisë, bashkëlidhur shpjegimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktin kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017, sipas së cilës ai i ka dhuruar vëllait të tij Gj. GJ. një sipërfaqe toke prej 1900 m² në fshatin {***}, Velipojë, të cilën e ka të regjistruar në ZVRPP Shkodër me nr. pasurie {***}, vol. {***}, faqe {***}, {***} dhe e ka blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.08.2014. Në paragrafin 3 të kësaj kontrate është shpjeguar edhe shkaku i vërtetë i këtij dhurimi, sipas të cilit: *kjo sipërfaqe toke që po i kalon Gj. GJ., është dhe si pjesë takuese e kontributit të tij për ndërtimin e shtëpisë së dhuruesit Pashk Gjaci në Laç, Kurbin. Shtohet se ky dhurim bëhet dhe si shpërblim për gjithë përkujdesjet që ka bërë dhe bën Gj. GJ. familjarisht ndaj dy prindërve të tij, sidomos në shtetin italian, të cilët janë në moshë të thyer dhe me probleme shëndetësore.*
47. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të interesave, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në vite pranë ILDKPKI-së, rezulton se në lidhje me këtë pasuri, ai ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës²¹, në vitin 2010, në të cilën ka deklaruar: *Tokë arë me sipërfaqe 4000 m², ndodhur në Velipojë, blerë në vitin 2010. Të ardhura të siguruara nga puna. Vlera 1400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*
Në deklarin periodik për vitin 2011, ka deklaruar²²: *Pakësim tokë arë nga 4.000 m² e deklaruar më parë, në Velipojë, me 1.600 m² (referuar aktmarrëveshjes për kompensim të pjesëve takuese në banesë, të babait dhe vëllait si më lart). Mbetem në disponim si pronar 2.400 m².*
48. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 43 të këtij vendimi, në raport me situatën faktike të përshkruar më sipër, duke vlerësuar si vijon.
Nga analizimi i deklarimeve periodike të interesave privatë, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në vite, rezulton se në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës²³, në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë mbi pasurinë tokë arë në fshatin {***}, në pjesë takuese 100%. Edhe në deklarin periodik të pasurisë për vitin 2011²⁴, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e kësaj pasurie, duke pasur të njëjtën qasje në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi të, duke e konsideruar veten pronar të kësaj pasurie. Në kuptim të arsytimit të vendimit nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të

²¹ Deklarata e pasurisë para fillimit të detyrës është dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, më datë 24.12.2010.

²² Aktmarrëveshja mes subjektit të rivlerësimit dhe të afërmeve të tij është lidhur më datë 02.01.2012, por duke qenë se deklarimi periodik bëhet në mars të vitit pasardhës, subjekti, në deklarin periodik për vitin 2011, ka deklaruar veprimin e kryer në janar të vitit 2012.

²³ Siç është pasqyruar në paragrafin 47, më sipër në këtë vendim.

²⁴ Aktmarrëveshja mes subjektit dhe të afërmeve të tij është lidhur më datë 02.01.2012, por duke qenë se deklarimi periodik bëhet në mars të vitit pasardhës, subjekti, në deklarin periodik për vitin 2011, ka deklaruar veprimin e kryer në janar të vitit 2012.

Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁵, e referuar edhe nga subjekti i rivlerësimit si një argument në mbështetje të shkakut të ankimit, deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, e z. N.N.²⁶, duke qenë një akt i njëanshëm, nuk mund të prodhonte efekte në lidhje me pronësinë e subjektit të rivlerësimit mbi sipërfaqen e tokës prej 4.000 m² në fshatin {***} [3.800 m² sipas kontratës së shitjes] e sidomos në kushtet kur vetë z. N. nuk mund të kryente veprime juridike me këtë pronë të tij, pasi nuk e kishte të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Me anë të kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit nuk mund të fitonte pronësinë mbi sipërfaqen e tokës 3.800 m², por mund të provonte vetëm pagesën prej tij të shumës 1.400.000 lekë, për efekt të deklarimit të pasurisë para fillimit të detyrës. Kjo deklaratë noteriale nuk arrin të vërtetojë as posedimin e kësaj sipërfaqeje toke nga subjekti i rivlerësimit, pasi pronari i saj, z. N., nuk kishte bërë regjistrimin e pasurisë tokë bujqësore në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe as ndarjen në pjesë të saj, që subjekti të mund të identifikonte se cila ishte parcela që do t'i përkiste atij, në mënyrë që ta posedonte atë. Ky fakt është pranuar dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni²⁷. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit të drejtën e pronësisë mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m² e ka fituar vetëm më datë 29.08.2014, me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., ndërsa të drejtën për të kryer veprime juridike me këtë pasuri [shitje, shkëmbim ose dhurim] e ka fituar në momentin e regjistrimit të saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë ZVRPP Shkodër, më datë 11.08.2016.

Për efekt të zgjidhjes së pretendimit në shqyrtim, trupi gjykues çmon se shprehja e vullnetit para noterit publik nga z. N. ka karakter deklarativ, në drejtim të njohjes apo pranimin prej tij se ka marrë shumën prej 1.400.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit, si dhe qëllimit të marrjes së kësaj shume - për hartimin e kontratës së mirëfilltë të shitblerjes në momentin e plotësimit të dokumentacionit dhe garantimit që këtë sipërfaqe ai nuk do t'ia shiste dikujt tjetër, në momentin që kjo pasuri do të ishte disponibël për shitje. Qëllimi tjetër i redaktimit të kësaj deklarate, ashtu siç është shprehur vetë deklaruesi, është që blerësi [subjekti i rivlerësimit] ta paraqiste në ILDKPKI. Edhe fakti që kjo deklaratë është redaktuar më datë 17.12.2010, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, më datë 24.12.2010, konfirmon këtë qëllim.

Në mbështetje të këtij arsyetimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk kishte të drejta pronësie mbi sipërfaqen e tokës prej 3.800 m² në fshatin {***}, përpara datës 29.08.2014, datë e lidhjes së kontratës së shitblerjes për këtë pasuri, dhe as nuk mund të kryente veprime juridike me këtë

²⁵ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1, datë 06.01.2009, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, kanë konkluduar: “[...] Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve. Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së saj (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. [...] Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve. [...] Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar edhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri. Është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta”.

²⁶ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, z. N. N. ka deklaruar se e zotëron sipërfaqen e tokës prej 4.000 m² në fshatin {***}, mbi bazën e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, datë 05.03.2004, pasi pasuria nuk është regjistruar ende në regjistrin e pasurive të paluajtshme, fakt ky i pranuar edhe nga vetë subjekti në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ.

²⁷ Siç është pasqyruar në paragrafin 44 të këtij vendimi.

pasuri para datës 11.08.2016, datë e regjistrimit të saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë ZVRPP Shkodër.

49. Në bazë të nenit 757 të Kodit Civil, i cili parashikon: “Shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues te tjetri”, i lidhur me nenin 760 të po këtij kodi, sipas të cilit: “Rregullat e caktuara për kontratën e shitjes zbatohen edhe për kontratën e shkëmbimit, për aq sa janë në pajtim me atë”, dhe në mbështetje të arsytimit të vendimit nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, aktmarrëveshja nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer me babanë dhe vëllanë një pjesë të sipërfaqes së tokës të ndodhur në {***}, Velipojë, me pjesët e tyre takuese në shtëpinë e banimit në Laç, nuk mund të sillte asnjë pasojë juridike, pasi subjekti nuk e kishte fituar ende pronësinë mbi sipërfaqen e tokës prej 3.800 m² në fshatin {***} dhe as nuk e kishte të regjistruar atë, që të mund të kryente shkëmbimin e saj me ndonjë pasuri tjetër. Siç do të analizohet edhe në vijim, as babai dhe as vëllai i subjektit nuk kishin asnjë të drejtë pronësie të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme²⁸ mbi shtëpinë e banimit trekatëshe në Laç, që të mund të kryenin shkëmbimin e pretenduar.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se veprimet juridike të përshkruara në aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, janë veprime fiktive, të cilat nuk kanë sjellë pasojë juridike, por duket se kanë patur për qëllim justifikimin e burimit të krijimit të pasurive nga subjekti i rivlerësimit, për efekt të deklarimit fillestar dhe periodik vjetor të interesave në ILDKPKI.

Mungesën e ardhjes së pasojave juridike nga aktmarrëveshja nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, e kanë pranuar dhe vetë palët nënshkruese të saj, të cilat kanë kryer një veprim tjetër juridik me pasurinë objekt i aktmarrëveshjes - kanë lidhur kontratën e dhurimit të pasurisë të paluajtshme, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit i dhuron vëllait të tij, z. Gj. Gj., pasurinë tokë arë me sipërfaqe 1.900 m² në fshatin {***}, Velipojë.

Veprimet juridike, të cilat, për shkak të plotësimit të kushteve ligjore sipas parashikimeve të Kodit Civil, kanë sjellë pasojë juridike mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 1.900 m², janë kryer nga subjekti i rivlerësimit pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit²⁹.

Në këtë rrjedhë arsytimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se veprimet juridike që ka kryer subjekti i rivlerësimit me këtë pasuri para momentit të deklarimit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk kanë sjellë asnjë pasojë juridike mbi të drejtën reale të pronësisë së tij. Për rrjedhojë, në momentin e deklarimit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ishte pronari i vetëm i pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m², ashtu siç rezulton e provuar edhe nga informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Shkodër³⁰.

50. Në zbatim të neneve 30 e 31 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë. Neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe

²⁸ Shtëpia e banimit trekatëshe, me sipërfaqe 140 m² në qytetin Laç (Kodër {***}) është regjistruar në ZVRPP Kurbin më datë 29.12.2011, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

²⁹ Ndarja e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m², në dy pasuri të tjera tokë arë me sipërfaqe 1.900 m² secila, është regjistruar në ZVRPP Shkodër, më datë 11.08.2015, me datë lëshimi certifikate 19.01.2017, ndërsa kontrata e dhurimit të pasurisë të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol. për njërin nga pjesët e ndara prej 1.900 m², nga subjekti i rivlerësimit kundrejt vëllait të tij, z. Gj. Gj., është nënshkruar më datë 08.09.2017.

³⁰ Siç është pasqyruar në paragrafin 44.5 të këtij vendimi.

të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë që sipas nenit 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049/2003, parashikohet se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]”.

Mbështetur në situatën faktike dhe ligjore të përshkruar më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, pasi të dhënat e pasqyruara në këtë deklaratë se ai zotëron 50% të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m² në fshatin {***}, Velipojë, nuk përkojnë me të drejtën reale që ai gëzonte mbi këtë pasuri, e cila në momentin e deklaramit për efekt të procesit të rivlerësimit ishte pronësia në pjesë takuese 100%.

Në deklaramin e pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar të gjitha veprimet juridike të kryera me pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m² të kryera deri në momentin e dorëzimit të deklaramit, pavarësisht pasojës së ardhur prej tyre, në përpjekje për të mbetur konsekuent i deklarameve të mëparshme të interesave, në të cilat ka pasqyruar vetëm veprimet që nuk kanë sjellë pasoja juridike, duke mos deklaruar ato që në fakt kanë krijuar të drejtën reale të pronësisë mbi këtë pasuri, në kundërshtim me sa parashikon ligji nr. 9049/2003.

Të gjithë këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e ka parë të lidhur me veprimet fiktive të kryera prej subjektit të rivlerësimit të përshkruara në paragrafët më sipër, të cilat nuk kanë sjellë asnjë pasojë juridike mbi pasurinë, por kanë pasur për qëllim justifikimin e burimit të krijimit të pasurive.

Trupi gjykues çmon të theksojë se në procesin e rivlerësimit konstatimi i fiktivitetit të veprimeve juridike nuk ka për qëllim dhe nuk mund të sjellë zgjidhjen e pasojave të palët pjesëmarrëse në të, por është një analizë e ligjshmërisë ose jo të veprimeve juridike të kryera, të cilat ndikojnë në legjitimitetin e pasurisë së krijuar si rezultat i këtyre veprimeve, për pasojë objekt verifikimi në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin e kriterit të pasurisë, qartësimi i titullit të pronësisë dhe i të drejtave reale të lidhura me të ka vlerë thelbësore për të përcaktuar saktësinë e deklaramit.

51. Në përfundim të arsyetimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm në deklaramit e pasurisë së rivlerësimit për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m² në fshatin {***}, Velipojë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

52. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shkelur nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, duke refuzuar pa të drejtë kërkesën e tij për të thirrur si dëshmitar z. N. N., i cili përtej asaj që kishte deklaruar para noterit publik, do t'i qartësonte Komisionit momente të tjera të rëndësishme lidhur me pasurinë tokë arë e ndodhur në fshatin {***}, trupi gjykues nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit, më datë 12.03.2019, së bashku me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka depozituar në Komision edhe kërkesën me lëndë: “Kërkesë për marrje të provave të reja shkresore dhe me dëshmitarë, në lidhje me hetimin administrativ dhe procedurën e rivlerësimit”, në të cilën, ndër të tjera, ka kërkuar të thërritet si dëshmitar z. N.N., banues në Velipojë, me qëllim që t'i provonte Komisionit kohën e likuidimit të shumëve për blerjen e pasurisë tokë arë në fshatin {***}, Velipojë dhe shkaku e vonësës së regjistrimit të saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme.*

Me vendimin e datës 15.03.2019, Komisioni, pasi ka shqyrtuar kërkesën e sipërcituar të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ka refuzuar kërkesën e tij për të thirrur si dëshmitar z. N.N., duke e çmuar si të panevojshme këtë dëshmi, përderisa ekziston deklarata noteriale e tij, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe e pranuar nga Komisioni.

Në seancën dëgjimore në Komision, më datë 19.03.2019, subjekti i rivlerësimit nuk e ka përsëritur kërkesën për thirrjen si dëshmitar të z. N.N.

53. Në analizë të kësaj situatë faktike në raport me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se paraqitja e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, e z. N. N., në të cilën ai deklaroi qëllimin e tij për t'i shitur subjektit të rivlerësimit një sipërfaqe toke arë prej 4.000 m², ndodhur në fshatin {***}, komuna Velipojë, Shkodër, si dhe faktin se ka marrë shumën 1.400.000 lekë, për të realizuar më pas kontratën e mirëfilltë të shitblerjes, kur dokumentacioni të jetë gati për të bërë të mundur këtë veprim juridik, gjatë hetimit administrativ nga ana e subjektit të rivlerësimit, ka ezauruar barrën e provës dhe të drejtën për të paraqitur prova mbi konstatimet e hetimit administrativ që i përket atij, bazuar në nenin 52 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur deklarata noteriale e sipërcituar është pranuar nga Komisioni, me vlerë të plotë provuese, bazuar në nenin 49, pika 6, fjalia e parë dhe shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme*, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit për refuzimin e kërkesës për marrjen dëshmitar të z. N.N., në raport me arsyet e paraqitjes së kësaj kërkesë nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë i drejtë.
54. Në pretendimet e tij në ankim, subjekti i rivlerësimit, përtej arsyeve të paraqitura në kërkesën drejtuar Komisionit, ka parashtruar se nëse z. N.N. do të dëshmonte në Komision, ai do të provonte edhe momente të tjera të rëndësishme për hetimin e plotë të çështjes, sepse siç rezulton nga arsyetimi i vendimit përfundimtar, Komisioni ka aluduar se edhe pasuri të tjera të vëllait të tij, z. Gj. GJ., janë në fakt pasuri të tijat. Subjekti i rivlerësimit nuk ka renditur se cilat janë këto pasuri dhe cilat do të ishin momentet që dëshmia e z. N.N. do të sqaronte për Komisionin. Edhe këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të paargumentuar dhe të pabazuar, pasi në përmbajtjen e vendimit përfundimtar të Komisionit, nuk gjenden gjurmë aludimi se pasuri të vëllait të subjektit të rivlerësimit, në fakt janë të tij.
55. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nëse do të ishte vënë në dijeni nga Komisioni për nevojën e marrjes së të dhënave në lidhje me vëllain e tij, atëherë ai do të kishte referuar me prova mbi faktin se vëllai i tij ka poseduar një pjesë të pasurisë tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, para regjistrimit të saj në emër të subjektit, trupi gjykues konstaton se në parashtrimet e tij në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, në ankim, por edhe në shpjegimet e paraqitura para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vëllai i tij, z. Gj. GJ., ka poseduar një pjesë të pasurisë tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, që para regjistrimit të saj në emër të subjektit, por vonesat në ndarjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3.800 m² në fshatin {***}, Velipojë, në dy pasuri të tjera me sipërfaqe 1.900 m² secila, të ardhura si pasojë e mosveprimit të ZVRPP Shkodër, e provuar sipas subjektit të rivlerësimit me kërkesat e tij drejtuar ZVRPP Shkodër dhe ministrit të Drejtësisë³¹, kanë bërë që kjo pasuri të regjistrohej me vonesë në emër të z. Gj. GJ..

³¹ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit këto akte:

- Kërkesë e z. Pashk Gjaci drejtuar ZVRPP Shkodër, me objekt: "Plotësimin e akteve administrative për ndarjen e pasurisë nr. {***}, vol. {***}, faqe {***} e ndodhur në ZK nr. {***}, fshati {***}, Njësia Administrative Velipojë, Bashkia Shkodër në emrin tim, lëshimin e akteve të reja të pronësisë dhe dërgimin e tyre në adresën e caktuar në momentin e aplikimit." Në këtë kërkesë subjekti shprehet se ky institucion, duke mos i kthyer përgjigje aplikimit të tij të datës 11.08.2015, po bëhet pengesë për deklarimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e tij, pranë ILDKPKI-së. Kërkesa ka bashkëlidhur një dëftesë komunikimi drejtuar ZVRPP Shkodër, e cila mban datën 12.01.2016.

Nga verifikimi i akteve që subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se kërkesën e parë për ndarjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3800 m² në dy të tjera dhe regjistrimin e këtyre të fundit në regjistrin e pasurive të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit ia ka drejtuar ZVRPP Shkodër, më datë 11.08.2015, ndërsa plotësimin e dokumentacionit për efekt të kësaj kërkesë e ka bërë më datë 25.10.2015, disa muaj më vonë nga lëshimi i certifikatës së regjistrimit të kësaj pasurie në emër të tij, në ZVRPP Shkodër [data e regjistrimit është 02.12.2014].

Sipas të dhënave të përcjella në Komision nga ZVRPP Shkodër, pasuria tokë arë me sipërfaqe 3800 m² është ndarë në dy pasuri të tjera tokë arë me sipërfaqe 1900 m² secila dhe data e lëshimit të certifikatës së pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit për secilën prej këtyre pasurive ka qenë data 19.01.2017. Kontrata e dhurimit³² të njëres prej këtyre pasurive nga subjekti i rivlerësimit kundrejt vëllait të tij, është lidhur më datë 08.09.2017, kohë më vonë nga data e lëshimit të certifikatës së pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit, moment ky që e bënte këtë pasuri disponibël për dhurim.

56. Në analizë të fakteve si më sipër, trupi gjykues çmon se vonesa në regjistrimin e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1900 m² në emër të z. Gj. GJ., nuk është varur vetëm nga vonesa e regjistrimit të ndarjes së pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3800 m², e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, por kryesisht nga vullneti i subjektit për të kryer veprimin juridik të dhurimit, i cili ka shërbyer si burim ligjor krijimi për pasurinë tokë arë 1900 m², në pronësi të z. Gj. GJ., sidomos kur rezulton se kontrata e dhurimit e sipërcituar është lidhur pas dorëzimit prej subjektit të rivlerësimit të deklaratës së pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit dhe gjatë zhvillimit të hetimit administrativ nga Komisioni.

Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, se nuk është vënë në dijeni nga Komisioni për nevojën e marrjes së të dhënave në lidhje me vëllain e tij, nuk qëndron, pasi nga verifikimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ³³ pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me konstatimet për pasurinë tokë me sipërfaqe 3800 m², rezulton se subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me pretendimin se vëllai i tij ka poseduar një pjesë të pasurisë tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, para regjistrimit të saj në emër të subjektit. Në këto kushte, ky pretendim i parashtruar nga subjekti në ankim, si argument justifikues për paraqitjen e provave të reja së bashku me ankimin³⁴, si dhe për kërkimin e marrjes së dëshmisë së vëllait të tij, Gj. GJ., në Kolegj, nuk provon pamundësinë e tij për të paraqitur këto akte dhe për të kërkuar marrjen e kësaj dëshmie gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision. Për këtë arsye, këto akte nuk u pranuan në cilësinë e provës nga trupi gjykues. Po ashtu, trupi gjykues vlerësoi si të panevojshme, në kuptim të parashikimeve

- Shkresë e z. Pashk Gjaci, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, datë 02.03.2016 me lëndë: Informacion në lidhje me mosfunksionimin sipas ligjit të ZVRPP Shkodër, në të cilën subjekti kërkon ndërhyrjen institucionale të Ministrit të Drejtësisë për zgjidhjen e kërkesës së tij drejtuar ZVRPP Shkodër, referuar aplikimit për ndarje pasurie, datë 11.08.2015.

- Kërkesë e z. Pashk Gjaci drejtuar ZVRPP Shkodër, me objekt: "Plotësimin e akteve administrative për ndarjen e pasurisë nr. {***}, vol. {***}, faqe {***} e ndodhur në {***} nr. {***}, fshati {***}, Njësia Administrative Velipojë, Bashkia Shkodër në emrin tim, lëshimin e akteve të reja të pronësisë dhe dërgimin e tyre në adresën e caktuar në momentin e aplikimit." Në këtë kërkesë subjekti shprehet se ky institucion, duke mos i kthyer përgjigje aplikimit të tij të datës 11.08.2015, i plotësuar me akte më datë 23.10.2015, po bëhet pengesë për deklarinimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e tij pra ILDKPKI-së. Kërkesa ka bashkëlidhur një dëftesë komunikimi drejtuar ZVRPP Shkodër, e cila mban datën 09.06.2016.

³² Kontrata e dhurimit të pasurisë së paluajtshme tokë arë 1,900 m² nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017 është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit së bashku me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit.

³³ Siç janë pasqyruar në paragrafin 44 të këtij vendimi.

³⁴ Bashkëlidhur ankimit, subjekti për të provuar pretendimin e tij se sipërfaqen e tokës prej 1.900 m², vëllai i tij e ka poseduar përpara lidhjes së kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017, ka paraqitur këto akte:

- Aplikim për legalizimin e ndërimit pa leje, i paraqitur në degën e ALUIZNI Shkodër, në datë 03.12.2014, nga z. Gj. Gj., i cili deklaroi se ka ndërtuar në vitin 2011, në fshatin {***}, Velipojë, një ndërtim pa leje.

- Certifikatë e gjendjes familjare me kryefamiljar Gj. Gj., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Velipojë.

të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, dëshminë e z. Gj. GJ., pasi dëshmia e z. Gj. GJ. nuk do të mund të provonte se ai e ka disponuar pasurinë tokë arë me sipërfaqe 1900 m² përpara lidhjes së kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017. Por edhe nëse do të provohej posedimi i kësaj sipërfaqeje nga z. Gj. GJ., nuk do të kishte asnjë ndikim në arritjen e konkluzionit, pasi vetëm posedimi nuk tregon kalimin e pronësisë.

57. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m² në fshatin {***}, Velipojë, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaratimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me pjesën zotëruese të saj, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se shkakut i ankimit mbetet i pambështetur në prova dhe vlerësimi i Komisionit për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m² në fshatin {***}, Velipojë, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, mbetet i drejtë.
58. Në lidhje me pasurinë shtëpi banimi trekatëshe në Laç, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi banimi 3 kate, me sipërfaqe ndërtimi 140 m² e truall 500 m², në lagjen nr. 2 të qytetit Laç, ndërtuar me leje ndërtimi përfundimtare në 2007, mbi banesën ekzistuese të prindërve me kontribut = aktmarrëveshje datë 02.01.2012 + deklaratë noteriale datë 10.08.2015. Vlera në momentin e regjistrimit 11.500.000 lekë, rivlerësimi 25.260.931 lekë. Pjesa takuese 100%”.
59. Në vendimin nr. 116, datë 21.03.2019³⁵, lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arsyetuar se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të paprovuara me dokumentacion ligjor, nuk mund të çlirojnë subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për të provuar mundësitë financiare të bashkëpronarëve në këtë pronë, si dhe të kundërshtojë aktin e kolaudimit dhe dokumentacionin tjetër ligjor provues mbi vlerën e objektit si dhe pronësinë mbi këtë pasuri. Nga hetimi i kryer, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar këtë pronë në vitin 2011 në ZVRPP, 100% në pronësi të tij. Nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka blerë në formën ligjore pronën prej 3800 m² tokë arë në fshatin {***}, Velipojë në vitin 2014 dhe e ka regjistruar 100% në pronësi të tij, megjithëse ai pretendon se sipërfaqen prej 1900 m² e kishte këmbyer me vëllain dhe babain, përkatësisht me pjesën takuese të tyre në shtëpinë e banimit 3-katëshe në lagjen nr. {***}, Laç. Kontrata e dhurimit për sipërfaqen e truallit mes subjektit të rivlerësimit, vëllait dhe babait të tyre është realizuar në shtator të vitit 2017, tetë muaj pas plotësimit të deklaratës së rivlerësimit. Në këtë deklaratë prona tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, është deklaruar në emër të subjektit të rivlerësimit, në masën 100%. Referuar vlerës së pasurive, të cilat janë këmbyer, Komisioni nuk i gjen ato në raport të drejtë dhe të përafërt. Bazuar në kontratën e shitblerjes, të datës 29 gusht 2014, subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m² në vlerën prej 1400.000 lekësh. Bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe në dokumentacion e administruar në dosje, vlera e ndërtimit të shtëpisë, vilë tre kate, në Laç, është 11.500.000 lekë, pasuri e cila është rivlerësuar në vitin 2012 në vlerën 25.260.931 lekë. Subjekti nuk arriti të bindë Komisionin lidhur me arsyet e deklaratimit të sipërfaqes së shtëpisë në 140 m², kur ajo në fakt është 191 m² si në lejen e ndërtimit, ashtu edhe në dokumentin e regjistrimit të pronës në ZVRPP. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar në mënyrë të saktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij dhe personave të tjerë të lidhur dhe ka fshehur sipërfaqen reale të ndërtesës shtëpi banimi 3-katëshe. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk provuan saktësinë dhe besueshmërinë e deklaratës së rivlerësimit. Në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Nga hetimi rezultoi

³⁵ Siç është pasqyruar në faqet 8 dhe 10 të vendimit nr. {***}, datë 21.03.2019 të Komisionit.

se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë në pronësi apo posedim të tij dhe personave të tjerë të lidhur, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe në deklaratimet periodike vjetore, duke bërë deklaram të rremë.

60. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë qëndrim të mbajtur nga Komisioni, duke parashtruar shkakun e ankimit, të analizuar nga trupi gjykues si më poshtë.
61. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se veprimet e kryera për ndërtimin e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç, janë referuar në emër të tij, duke respektuar legjislacionin në fuqi, megjithëse kontributi i tij ka qenë në masën 33%, i barabartë me atë të babait dhe vëllait të tij. Kontributet e babait dhe të vëllait janë njohur nga subjekti i rivlerësimit dhe janë kompensuar sipas aktmarrëveshjeve të lidhura mes tyre me vullnet të lirë, të cilat janë deklaruar saktësisht prej tij në deklaratimet e pasurisë në vite dhe në deklaratën e rivlerësimit, pa pasur si qëllim fshehjen apo deklarimin e rremë të kësaj pasurie. Ai ka pasqyruar ndryshimet e pjesshme të së drejtës reale të pronës, kronologjikisht, por veshja me formën e duhur ligjore ka ndodhur më vonë.*
62. Në analizë të këtij pretendimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton situatën faktike, e cila paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.
63. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, sipas informacionit të përcjellë nga ZVRPP Kurbin, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në emrin e tij pasurinë truell 500 m² dhe ndërtesë 191 m², tri kate, me nr. pasurie {***}, Zona Kadastrale {***}, volum {***}, faqe {***}, Laç. Sipas dokumentacionit që përmban praktika e regjistrimit të kësaj pasurie, dokumentacionit justifikues që ka depozituar subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI së bashku me deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të paraqitur bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, rezulton se:
- 63.1 Me vendimin nr. {***}, datë 20.05.1997, “Për miratim sheshe ndërtimi” të Këshillit të Bashkisë Laç, i është miratuar leja e ndërtimit disa qytetarëve, ndërmjet të cilëve dhe z. N. GJ..
- 63.2 Me vendim të KRrT-së së rrethit Kurbin, nr. {***}, datë 16.10.1997, është dhënë leje ndërtimi për z. N. GJ., për ndërtimin e një shtëpie banimi në Kodër {***}, me financim nga vetë personi.
- 63.3 Në datë 10.11.2002, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij, z. N. GJ., është lidhur një aktmarrëveshje, në të cilën palët kanë deklaruar: *Unë N. GJ. jam pajisur nga këshilli i rrethit Kurbin me lejen e ndërtimit me nr. {***}, datë 16.10.1997, për ndërtim shtëpie private, në Kodër-{***}. Si pasojë, ky institucion me ka dhënë edhe sheshin e ndërtimit me sipërfaqe prej 500 m². Duke qenë se ndërtimi i këtij objekti do të bëhet nga djali im, Pashk Gjaci, për t’i krijuar kushtet ligjore djalit tim, për t’u pajisur me leje ndërtimi në emrin e tij për ndërtimin e këtij objekti, deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se lejoj djalin tim të ndërtojë banesën e tij mbi sheshin e ndërtimit që më është dhënë mua nga institucionet. Në momentin që unë do të bëhem pronar i ligjshëm i truallit të dhënë me lejen e sheshit të ndërtimit, këtë pronë do t’ia kaloj në pronësi djalit tim, Pashk Gjaci. Edhe unë Pashk Gjaci jam dakord me sa deklaron babai im.*
- 63.4 Subjekti i rivlerësimit më datë 10.12.2002, në cilësinë e investitorit, ka lidhur kontratë me shoqërinë {***} ShPK në cilësinë e sipërmarrësit, për ndërtimin e një banese me tri kate në Laç. Sipërmarrësi ka marrë përsipër të kryejë punimet e ndërtimit për një afat 5-vjeçar, në vlerën 8.355.400 lekë. Detyrimi i investitorit është pagesa ndaj sipërmarrësit e 10% të vlerës së preventivuar me lidhjen e

kësaj kontrate, si dhe pagesa e situacioneve pjesore 15-ditore, brenda 5 ditësh nga paraqitja e tyre. Afati i përfundimit të kontratës është data 10.12.2007.

63.5 Sipas lejes së ndërtimit, datë 15.01.2003, të KRrT-së, Bashkia Laç, subjektit ndërtues {***} ShPK, me vendim të KRrT-së nr. {***}, datë 12.11.2002, i është miratuar leje ndërtimi për z. Pashk Gjaci, për objektin shtëpi banimi tri kate, {***}. Afati kohor i kësaj leje ndërtimi është deri më datë 12.11.2003.

63.6 Sipas mandatarkëtimit nr. {***}, datë 15.05.2003, z. Pashk Gjaci ka paguar shumën 175.308 lekë, për leje ndërtimi dhe taksë sipërfaqeje. Mandati përmban nënshkrimin e arkëtarit dhe vulën e Bashkisë Laç.

63.7 Me anë të kontratës së shitjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2003, babai i subjektit të rivlerësimit, z. N. GJ., ka blerë nga Bashkia Laç, truallin me sipërfaqe 500 m², i ndodhur në lagjen nr. {***}, Laç. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pasuria e cila ndodhet në zonën kadastrale 1298 është shitur në vlerën 190000 lekë, vlerë e cila është likuiduar nga z. N. GJ. sipas mandatit të arkëtimit nr. 231, datë 11.06.2003. Bashkëlidhur kontratës gjendet mandatarkëtimi nr. {***}, datë 11.06.2003, për shumën 190000 lekë, paguar nga N. P. N., për blerje tokë bujqësore 500 m², i cili përmban nënshkrimin e arkëtarit dhe vulën e Bashkisë Laç.

63.8 Në aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2003, e lidhur mes z. M. N. dhe z. N. GJ., z. M. N. deklaron se i ka dhënë për ndërtime z. N. GJ. katër troje, që në vitin 1995, kundrejt shpërblimit për të cilin kanë rënë dakord dhe është paguar nga blerësi. Ai deklaron gjithashtu se plotësimi i dokumentacionit ligjor do të realizohet në momentin e njohjes së të drejtës së shitësit (deklaruesit), për kalimin e pronësisë së paluajtshme me akt noterial dhe regjistrimin e saj.

63.9 Më tej, për ndërtimin e shtëpisë së banimit me tri kate në Laç, rezulton të jenë ndërmarrë hapat e dokumentuar në aktet përkatëse³⁶.

³⁶ Për ndërtimin e shtëpisë së banimit me tri kate në Laç, janë ndërmarrë hapat e dokumentuar në aktet e mëposhtme, të renditura në mënyrë kronologjike.

○ Preventiv për veprën “Shtëpi banimi tri kate, lagjia nr. {***}, {***}, Laç”, në vlerën 8.355.400 lekë, nënshkruar nga drejtuesi teknik i shoqërisë “{***}” ShPK.

○ Akt kontrolli për pikekim objekti, për objektin “Shtëpi banimi tri kate, lagjia nr. {***}2, {***}, Laç”, i Bashkisë Laç, me nr. {***} prot., datë 16.01.2003, si dhe procesverbal pikekimi, datë 16.01.2003.

○ Akt kontrolli për përfundimin e kuotës 0+00, për objektin Shtëpi banimi {***} kate, lagjia nr. {***}, Kodër Sanxhak, Laç, i Bashkisë Laç, me nr. ekstra prot., datë 10.07.2003, si dhe procesverbal për përfundimin e kuotës 0+00, datë 10.07.2003.

○ Akt kontrolli për përfundimin e fazës së karabinasë, për objektin shtëpi banimi {***} kate, lagjia nr. {***}, {***}, Laç, i Bashkisë Laç, me nr. ekstra prot., datë 15.10.2006, si dhe procesverbal për përfundimin e fazës së karabinasë, datë 15.10.2006.

○ Kontratë sipërmarrjeje për mbikëqyrje punimesh për objektin shtëpi banimi me {***} kate, lagjia nr. {***}, {***}, Laç, e lidhur më datë 10.12.2007 midis investitorit Pashk Gjaci dhe inxhinier M. P.. Sipas paragrafit I, pika 3 e kësaj kontrate, pagesa e mbikëqyrësit të punimeve është 150.000 lekë.

○ Procesverbal i mbikëqyrësit të punimeve inxhinier M. P., sipas të cilit data e lidhjes së kontratës mes investitorit dhe njëkohësisht pronarit të truallit Pashk Gjaci dhe sipërmarrësit kontraktues “{***}” ShPK, është data 10.12.2002; vlera e kontratës me TVSh është 8.335.404 lekë; vlera e shpenzimeve sipas situacionit përfundimtar është 8.335.404 lekë; data e fillimit të punimeve është 16.01.2003 dhe data e mbarimit të punimeve është 10.12.2007. Punimet janë kryer konform të dhënave të kontratës dhe sipas kushteve teknike.

○ Relacion përmbledhës për përfundimin e punimeve në objektin shtëpi banimi me tri kate, lagjia nr. {***}, {***}, Laç, datë 10.12.2007, sipas të cilit punimet e ndërtimit kanë përfunduar më datë 10.12.2007 dhe janë kryer konform të dhënave të kontratës dhe kushteve teknike. Relacioni është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve inxhinier M. P..

○ Situacion i veprës shtëpi banimi me tri kate, {***}, lagjia nr. {***}, Laç, me investitor Pashk Gjaci, me vulë të “{***}” ShPK dhe i nënshkruar nga Xh.S. (emër, mbiemër, nënshkrim), me vlerë 8.335.404 lekë.

○ Faturë tatimore shitjeje nr. {***}, datë s’ka, e lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë 8.335.404 lekë dhe e nënshkruar nga blerësi Pashk Gjaci, ndërsa për shitësin “{***}” ShPK, personi nënshkruar nuk identifikohet, pasi fatura përmban vetëm një nënshkrim pa emër e mbiemër të personit nënshkruar.

63.10 Më datë 02.01.2012, subjekti i rivlerësimit ka lidhur me babanë e tij, N. GJ., dhe vëllanë e tij, Gj. GJ., aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, përmbajtja e së cilës është pasqyruar në paragrafin 44.3 të këtij vendimi.

64. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni³⁷, ka shpjeguar në mënyrë të përmbledhur: *Në momentin e plotësimit të deklaratës para fillimit të detyrës, pasuria në fjalë ishte akoma e paregjistruar dhe referencat për sipërfaqen janë bërë nga ana ime jo për të fshehur këtë pasuri. [...] Kam deklaruar në aktmarrëveshjet me babain dhe vëllain se banesa ime është ndërtuar mbi ndërtesën ekzistuese të babait, i cili ka qenë i pajisur me leje ndërtimi në vitin 1997 me vendim të KRRt-së së rrethit Kurbin. Para se të mernte lejen e ndërtimit, babai im në vitin 1995 ka blerë privatisht dhe të cilësuar për troje ndërtimi, një sipërfaqe toke në atë kohë “arë” nga trashëgimtarët ligjorë të pronarit, e legalizuar me akt noterial në vitin 1999, për të mos pasur probleme ose konflikte pronësie me persona të tretë. Megjithatë, derisa ky shtetas nuk e kishte të regjistruar si të kthyer këtë sipërfaqe toke, sipërfaqen e truallit të ndërtesës sime prej 500 m², unë e kam blerë edhe nga bashkia Laç, për efekt të lejes së ndërtimit, por babai ka garantuar para autoriteteve se nuk ka konflikt me ish-pronarët, pa të cilën nuk mund të pajisej me leje ndërtimi. Në mungesë të dokumentacionit dhe në mirëkuptim me organet e qeverisjes vendore të asaj kohe, është pranuar që të më jepej leja e re e ndërtimit, duke konsideruar se ndërtimi do të kryhej nga e para, por janë shfrytëzuar parametrat ekzistues të katit të parë, duke i shtuar shkallë të jashtme dhe një dhome poshtë tyre, ngjitur me banesën ekzistuese dhe duke e ngritur dy kate të tjera, tashmë jo me bazë dhe me sipërfaqe 140 m², por aq sa është pasqyruar në aktin e pronësisë. [...] që të deklarohet e vërteta përpara autoriteteve ligjore, e kam deklaruar këtë pasuri sipas përshkrimit në deklaratën e parafillimit të detyrës, se është realizuar me kontribut të përbashkët të babait, timin dhe të vëllait, në raport me 1/3 ose 33% secili. Sipas lejes së ndërtimit në emër të babait, N. GJ. (1997), planimetrisë dhe skicës së objektit bashkëlidhur këtij dokumenti, provohet se sipërfaqja e ndërtimit të katit të parë ka qenë 140 m² dhe më*

o Kontratë sipërmarrjeje kolaudimi për objektin shtëpi banimi me {***} kate, lagjja nr. {***}, {***}, Laç, e lidhur më datë 10.12.2007, ndërmjet investitorit Pashk Gjaci dhe kolaudatorit inxhinier P. P.. Ky i fundit, sipas nenit 2 të kontratës së cituar më sipër, merr përsipër realizimin e objektit të kësaj kontrate për vlerën 16.000 lekë, brenda një muaji nga data e lidhjes së kontratës. Sipas nenit 7 të kontratës, data e marrjes në dorëzim të aktit të kolaudimit do të konsiderohet si datë e përfundimit të këtij shërbimi.

o Akt kolaudimi tekniko-ekonomik për objektin shtëpi banimi me tri kate, Kodër Sanxhak, lagjja nr. {***}, Laç, investitori Pashk Gjaci, sipërmarrësi “{***}” ShPK Kurbin, kolaudator inxhinier P. P.. Sipas këtij akti kolaudimi të mbajtur më datë 08.11.2011, objekti shtëpi banimi me 3 kate, Kodër Sanxhak, është ndërtuar sipas projektit të miratuar nga KRRT e Bashkisë Laç, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 500 m², sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit është 191 m². Data e fillimit të punimeve është 10.01.2003, data e përfundimit të punimeve sipas kontratës është 10.12.2007, data e përfundimit të punimeve njoftim i sipërmarrësit 10.12.2007, afati sipas kontratës 5 vjet, periudha e realizimit të punimeve 16.01.2003 deri 10.12.2007. Vlera e shpenzimeve për objektin, situacioni përfundimtar 8.335.404 lekë. Çmimet e zbatuara në situacionin përfundimtar janë sipas preventivit.

o Akt kontrolli përfundimtar, për objektin shtëpi banimi me {***} kate, lagjja nr. {***}, {***}, Laç, i Bashkisë Laç, me nr. ekstra prot., datë 10.12.2007, si dhe procesverbal verifikimi përfundimtar datë 10.12.2007, i nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK, investitori Pashk Gjaci dhe mbikëqyrësi i punimeve Mëhill Paçuku.

o Certifikatë e marrjes në dorëzim shtëpi banimi me {***} kate, {***}, lagjja nr. {***}, Laç e mbajtur më datë 10.10.2011 midis investitorit dhe njëkohësisht pronarit të truallit Pashk Gjaci, sipërmarrësit kontraktues “{***}” ShPK, i përfaqësuar nga z. Xh. S. dhe mbikëqyrësit të punimeve inxhinier M. P..

o Shkresë nr. {***} prot., datë 23.12.2011, e bashkisë Laç, Seksioni i Urbanistikës, “Leje shfrytëzimi”, për objektin shtëpi banimi me tri kate, lagjja nr. {***}, {***}, Laç, me sipërfaqe trualli 500 m² dhe ndërtimi 191 m².

o Shkresë nr. {***} prot., datë 23.12.2011, e bashkisë Laç, Seksioni i Urbanistikës, me lëndë: “Dërgim dokumentacioni për hipotekim”, drejtuar ZRPP Kurbin.

³⁷ Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjen: “[...] ju nuk keni deklaruar pjesën e investuar nga babai dhe vëllai, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre. Sipërfaqja e objektit ndërtimor është deklaruar nga ana juaj 140 m², por sipas gjithë dokumentacionit të ndodhur në dosje dhe vërtetimit të ZVRPP Kurbin, rezulton 191 m². [...] Duket se ky objekt [shtëpia e banimit tri kate] është blerë dhe ndërtuar tërësisht nga ju dhe referuar analizës financiare mbi të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti juaj privat, ju nuk justifikoni burimin e ligjshëm të investimit në këtë objekt”.

pas, në zbatim të lejes së re të ndërtimit në emrin tim, rezulton sipërfaqja shtesë e deklaruar sipas aktit të regjistrimit të kësaj pasurie. Në të tilla kushte, babai përveçse ka blerë truallin, ku ka ndërtuar shtëpinë njëkatëshe me sipërfaqe ndërtimi 140 m² para vitit 2002, [...] ka punuar dhe fizikisht për kryerjen e shumë proceseve të punës, duke qenë me banim të përhershëm në katin e parë të ndërtesës që po ngrihej. Ky kontribut ka vijuar me autorizimin e përfaqësimit, deri në përmbylljen e akteve të regjistrimit në ZVRPP Laç. Babai ka qenë në përbërje familjare me vëllain. Të ardhurat për blerjen e pasurive të tij, babai i ka siguruar nga puna e tij, si dhe dërgimin e tyre nga vëllai si emigrant ekonomik në Itali. [...] Përveç kësaj, vëllai ka qenë me profesion ndërtues, ka punuar vetë kohë pas kohe pa qenë nevoja ta dokumentonte këtë deri në përfundim të ndërtimit të banesës. [...] Pas aplikimit tim për t'u pajisur me leje ndërtimi dhe për fatin e mirë që u dha vetëm në emrin tim, pavarësisht kontributeve të tyre, derisa kisha mirëkuptimin se detyrimet e ndërsjella ne do t'i rregullonim me marrëveshje, unë kam autorizuar babain të mbikëqyrte punimet e firmës së ndërtimit etj., dhe të kryente të gjitha veprimet e tjera administrative për të realizuar përfundimisht plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe regjistrimin e kësaj pasurie në emrin tim, si familje, për të mos pasur nevojën e pjesëtimit të pasurisë, nisur nga fakti, se duke qenë me shërbim në Përmet, nuk mund t'i ndiqja vetë veprimet administrative deri në regjistrimin e pasurisë. [...] Duke njohur kontributet e babait dhe vëllait kam realizuar marrëveshjet përkatëse, të cilat aktualisht janë vënë në funksion të plotë. Aktualisht është regjistruar 100% në emrin tim ndërtesa e banimit në {***}, Laç, ndërsa pasuria tokë "arë" që ndodhet në fshatin {***}, Velipojë, është pakësuar me 50%. Mbajtja e kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017, për pakësimin e pasurisë, edhe pse nuk është regjistruar në ZVRPP Shkodër, nuk është më në emrin tim as juridikisht, sipas nenit 83 të Kodit Civil dhe vendimit njësuës nr. 1/2009.

65. Në shtjellim të pretendimit të tij në ankim sipas paragrafit 61 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar referencën e Komisionit në vendim se babai e ka lejuar të ndërtojë mbi truallin që i është dhënë nga shteti. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se shteti, i përfaqësuar nga bashkia mund të jepte troje në funksion të dhënies së lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit nga pronat publike në administrim të bashkisë, por në rastin konkret këto troje kanë qenë të njohura ish-pronarit dhe jo në pronësi të shtetit, ndërsa babai i tij priste të bëhej pronar nga shtetasi M. N., pasi ai të kishte regjistruar pronën që i kishte shitur që në vitin 1995. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar gjithashtu se babai i ka dhënë pëlqimin që ai të ndërtonte jo thjesht mbi truallin, por edhe mbi ndërtesën njëkatëshe të ndërtuar në funksion të lejes së vitit 1997.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit dhe në mbështetje të situatës faktike të përshkruar më sipër³⁸, trupi gjykues vëren se nga deklarimi i z. M. N. në aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2003, e lidhur mes tij dhe z. N. GJ. ,babait të subjektit të rivlerësimit, rezulton se z. N. nuk ka pasur të drejta pronësie mbi sipërfaqen e trojeve, të cilat pretendon se ia ka shitur babait të subjektit të rivlerësimit. Në kuptim të disponimit të vendimit nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, z. N. nuk mund të kryente veprime juridike me këto troje, pasi nuk i kishte ende të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Për këtë arsye, aktmarrëveshja nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2003, e lidhur mes z. M. N. dhe z. N. GJ., nuk mund të prodhonte efekte në lidhje me pronësinë e z. N. GJ. mbi trojet e pretenduara. Trupi gjykues nuk mund të qëndrojë pa vënë re se kjo aktmarrëveshje është nënshkruar më datë 31.12.2003, rreth një vit më vonë nga data e marrjes së lejes së ndërtimit nga subjekti i rivlerësimit [data 12.11.2002] dhe 6 muaj më vonë nga lidhja e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie ndërmjet z. N. GJ., në cilësinë e blerësit, dhe Bashkisë Laç, në cilësinë e shitësit.

³⁸ Sipas paragrafëve 63 dhe 64 të këtij vendimi.

Në aktmarrëveshjen e datës 10.11.2002, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij, z. N. GJ., ky i fundit ka deklaruar se me vullnet të lirë e të plotë lejon djalin e tij të ndërtojë banesën mbi sheshin e ndërtimit që i është dhënë atij nga institucionet. Ai vijon deklarin se në momentin që do të bëhet pronar i ligjshëm i truallit, këtë pronë do t'ia kalojë në pronësi djalit të tij, Pashk Gjaci. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, por edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ³⁹, ka pranuar që truallin mbi të cilin do të ndërtonte shtëpinë trekatëshe e ka blerë nga Bashkia Laç, pasi babai i tij kishte marrëveshje me trashëgimtarin e ish-pronarit, por meqenëse ky veprim nuk njihej sepse nuk kishte formën e duhur ligjore, i është dashur ta blinte truallin në funksion të lejes së ndërtimit, duke paguar shumën e caktuar nga autoritetet e Bashkisë. Ky deklarin i subjektit të rivlerësimit është vërtetuar nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2003, e lidhur mes z. N. GJ., në cilësinë e blerësit, dhe Bashkisë Laç, në cilësinë e shitësit, për blerjen e një trualli me sipërfaqe 500 m². Si rezultat i këtyre rrethanave faktike, trupi gjykues arrin në konkluzionin se babai i subjektit të rivlerësimit, pronësinë mbi truallin me sipërfaqe 500 m² e ka fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së lidhur me Bashkinë Laç.

Ky truall 500 m², së bashku me ndërtesën 191 m², sipas vërtetimit hipotekor të ZVRPP Kurbin, është regjistruar më datë 29.12.2011, në emër të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të bazuar në dokumentacion konstatimin e Komisionit në vendim se *babai e ka lejuar subjektin të ndërtojë mbi truallin që i është dhënë nga shteti*.

66. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar edhe konstatimin e Komisionit se *nuk ka një akt ligjor që vërteton kalimin e pronësisë së truallit nga babai në emër të subjektit, megjithëse ai rezulton i regjistruar në vitin 2011 në emër të subjektit të rivlerësimit (truall + ndërtesë)*. Subjekti ka argumentuar se ky konstatim nuk është i drejtë, pasi gjatë hetimit administrativ ka sqaruar se babai i tij ka blerë truallin prej 500 m² nga Bashkia Laç, për llogari të subjektit, edhe pse subjekti nuk i kishte lëshuar një akt të posaçëm përfaqësimi, e këto veprime janë pranuar nga autoritetet e bashkisë së asaj kohe.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, mbështetur në situatën faktike të pasqyruar si më sipër në paragrafët 63 dhe 64 të këtij vendimi, trupi gjykues vëren se truallin me sipërfaqe 500 m² është regjistruar në ZVRPP Kurbin, në vitin 2011, në emër të subjektit të rivlerësimit, së bashku me ndërtesën e banimit trekatëshe me sipërfaqe 191 m².

Në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2003, të lidhur ndërmjet z. N. GJ. dhe Bashkisë Laç, nuk referohet se z. N. GJ. vepron si përfaqësues i një personi fizik apo juridik, por përkundrazi në cilësinë e palës shitëse, Bashkia Laç ka deklaruar se “sipërfaqja e truallit prej 500 m² është dhënë me vendim të KRRR të rrethit Kurbin nr. {***}, datë 16.10.1997”, që vërteton faktin se kjo sipërfaqe trualli i është shitur babait të subjektit të rivlerësimit në funksion të lejes së ndërtimit që i ishte dhënë atij në vitin 1997, nga Bashkia Laç.

Në aktmarrëveshjen e datës 10.11.2002 [shkresë e thjeshtë, jo akt i redaktuar nga noteri publik], z. N. GJ. ka deklaruar se në momentin që do të bëhej pronar i ligjshëm i truallit me sipërfaqe 500 m², të drejtën e pronësisë mbi këtë truall do t'ia kalonte djalit të tij, z. Pashk Gjaci. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se nuk ka një akt ligjor në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil, që vërteton kalimin e pronësisë së truallit nga z. N. GJ. te subjekti i rivlerësimit, megjithëse z. N. GJ. ka fituar pronësinë e truallit prej 500 m² më datë 11.06.2003, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2003.

Trupi gjykues vlerëson se rrethanat faktike si më sipër nuk vërtetojnë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë gjendet i drejtë konstatimi i Komisionit se nuk ka një akt ligjor që vërteton

³⁹ Sipas paragrafit 64 të këtij vendimi.

kalimin e pronësisë së truallit me sipërfaqe 500 m² nga z. N. GJ. në emër të subjektit, megjithëse ai rezultoi i regjistruar në vitin 2011 në emër të subjektit të rivlerësimit.

67. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se të gjitha veprimet e kryera për ndërtimin deri në regjistrimin e pronës shtëpi banimi me tri kate në Laç, rezultojnë të jenë kryer prej tij, si pronar i vetëm i kësaj pasurie, duke argumentuar se është e vërtetë se juridikisht të gjitha veprimet e kryera për ndërtimin e kësaj shtëpie janë referuar në emrin e tij, sepse kështu e kërkonte legjislacioni i kohës, por për të njohur dhe kompensuar pjesët e kontributeve të babait dhe vëllait të tij, janë mbajtur përpara noterit publik aktmarrëveshjet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se u qëndron të gjitha deklaratimeve që ka bërë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratat periodike vjetore, pasi ai nuk kishte si të mohonte kontributet e babait dhe vëllait të tij dhe as t'u kthente atyre pjesën e kontributeve pa e dokumentuar këtë veprim, sepse kjo do të përbënte shkelje të ligjit.

Në analizë të këtij pretendimi dhe të dokumentacionit të referuar në konstatimin e situatës faktike në paragrafët 63 dhe 64 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka qenë investitor i vetëm i objektit shtëpi banimi me tri kate, në Laç dhe aktet që i përkasin ndërtimit dhe regjistrimit të këtij objekti në regjistrin e pasurive të paluajtshme janë nënshkruar prej tij. Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore, i lëshuar nga ZVRPP Kurbin, pasuria me nr. {***}, Zona Kadastrale {***}, në qytetin Laç, truall 500 m², ndërtesë 191 m² me tri kate, figuron e regjistruar në pronësi të pronarit të vetëm, z. Pashk Gjaci, pasuri e regjistruar më datë 29.12.2011.

Nga këto të dhëna dokumentare, nuk vërtetohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit që shtëpia trekatëshe e banimit, të jetë ndërtuar mbi shtëpinë ekzistuese të babait të tij. Po ashtu nuk rezultoi e dokumentuar që babai ose vëllai i tij të kenë kontribuar në ndërtimin e shtëpisë së banimit me tre kate në Laç.

Trupi gjykues, në vijim të arsytimit të bërë në paragrafin 49 më sipër në këtë vendim, vlerëson se aktmarrëveshja nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe babait e vëllait të tij, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer një pjesë të pasurisë tokë arë në fshatin {***}, Velipojë, me pjesët takuese të babait e vëllait të tij në shtëpinë e banimit trekatëshe, nuk mund të kishte si qëllim ardhjen e një pasojë juridike, pasi në kohën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje, pasuria shtëpi banimi me tri kate ishte regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit si pronar i vetëm, që më datë 29.12.2011. Pasuria shtëpi banimi me tri kate, ashtu siç referojnë aktet e hartuara për nevojat e realizimit të punimeve të ndërtimit, është ndërtuar në periudhën kohore 2002-2007, ndërsa marrëveshjet me babain dhe vëllanë e tij për evidentimin e pjesëve takuese të pretenduara, subjekti i rivlerësimit i ka lidhur shumë kohë më vonë, në vitin 2012, kohë që përkon me qenien e tij zyrtar deklarues i interesave private pranë ILDKPKI-së.

Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shtëpia e banimit me tri kate në Laç është ndërtuar nga subjekti i rivlerësimit, si investitor i vetëm. Veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si shkëmbim i një pjese të pasurisë së tij me kontributet e babait dhe vëllait të tij, duke mos pasur si qëllim ardhjen e pasojave juridike, janë kryer për t'u përdorur si justifikim për burimin e krijimit ose financimit të pasurive me kontribute të babait e të vëllait të tij, për efekt të deklarimit fillestar dhe atij periodik vjetor të interesave, në ILDKPKI.

Në këto kushte, deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se pasuria shtëpi banimi trekatëshe, në Laç, është ndërtuar edhe me kontributin e babait dhe vëllait të tij, nuk i përgjigjet së vërtetës, duke u kualifikuar si deklarim i rremë në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

68. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përfundimin e arritur nga Komisioni në vendim⁴⁰ se ka fshehur sipërfaqen reale të ndërtesës shtëpi banimi trekatëshe në Laç, duke argumentuar se shtëpia është ndërtuar mbi banesën ekzistuese të babait të tij, duke iu shtuar shkallë e jashtme dhe një ambient, që bën diferencën e sipërfaqes nga 140 m² sipas lejes së ndërtimit në emër të babait të tij, në 191 m² sipas lejes dhe dokumentacionit të pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues, në analizë të situatës faktike të pasqyruar në paragrafët 63 dhe 64 të këtij vendimi, vëren se sipas aktit të Bashkisë Laç “Leje shfrytëzimi”, për objektin shtëpi banimi tri kate, lagjja nr. {***}, {***}, Laç, subjektit të rivlerësimit i është dhënë leja për të shfrytëzuar një objekt banimi me sipërfaqe 191 m², me tri kate, në një sipërfaqe trualli prej 500 m². Edhe aktet e hartuara nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori, të kontraktuar nga subjekti i rivlerësimit, referojnë sipërfaqen prej 191 m², si sipërfaqe e ndërtimit të objektit shtëpi banimi me tri kate. Sipas aktit “Vërtetim nga dokumentet hipotekore” i ZVRPP Kurbin, figuron e regjistruar në pronësi të Pashk N. Gjaci, pasuria me nr. {***}, Zona Kadastrale {***}, në qytetin Laç, truall 500 m², ndërtesë 191 m², tri kate.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në parashtrimet në ankim, pranon se sipërfaqja e ndërtimit të kryer është 191 m², ndërsa sipërfaqja prej 140 m² i përket ndërtimit fillestar të kryer nga babai i tij, sipas lejes së ndërtimit të vitit 1997. Subjekti është përpjekur të shpjegojë se ka deklaruar sipërfaqen 140 m² si sipërfaqe ndërtimi, për të evidentuar se shtëpia është ngritur mbi ndërtimin e kryer më parë nga babai i tij, i konsideruar në aktmarrëveshjen e datës 02.01.2012, si kontributi i babait të tij me 1/3 pjesë, në ndërtimin e shtëpisë trekatëshe.

Trupi gjykues, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit për justifikimin e mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së ndërtimit të shtëpisë së banimit tri kate në Laç, i konsideron jorelevante, pasi sipas nenit 31, pika 1 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 [deklaratës së pasurisë së rivlerësimit], ai kishte detyrimin të deklaronte pasurinë sipas të dhënave të certifikatës së pronësisë së lëshuar nga ZVRPP Kurbin.

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë dhe në dijeni të plotë të sipërfaqes reale të shtëpisë së banimit në pronësi të tij, të regjistruar në regjistrat publikë, por në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar një sipërfaqe ndërtimi, e cila nuk i përgjigjet së vërtetës, me qëllim evidentimin e kontributit të pretenduar të babait të tij, kontribut i cili do të justifikonte burimin e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit të shprehur në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të rremë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

69. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit se: *Referuar vlerës së pasurive, të cilat janë këmbyer, Komisioni nuk i gjen ato në raport të drejtë dhe të përafërt*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vërtet juridikisht pasuria tokë në fshatin {***}, Velipojë, njihet si tokë bujqësore, por për shkak të pozicionit gjeografik dhe dokumentacionit të rregullt, në rast transaksioni, vlera e saj e kalon 1/3 e vlerës së shtëpisë së banimit trekatëshe, në Laç.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon t’i rikthehet konkluzionit të arritur më sipër në këtë vendim, sipas të cilit aktmarrëveshja nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, e lidhur mes N. Gj. , Pashk Gjaci dhe Gj. GJ. për shkëmbimin e pasurive të tyre, është një veprim juridik fiktiv, i cili nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për palët. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, sipërfaqen e tokës bujqësore prej 1900 m² në fshatin {***}, Velipojë, ia ka dhuruar vëllait të tij, z. Gj. GJ., sipas kontratës së dhurimit të pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2017.

⁴⁰ Sipas paragrafit 13, në faqen 8 të vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit.

Në këto kushte, trupi gjykues, konkluzionin e mësipërm të Komisionit dhe argumentet e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të tij, nuk i konsideron relevante për zgjidhjen e çështjes.

70. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me burimin e krijimit dhe sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë shtëpi banimi trekatëshe në Laç, plotëson kushtet për t'u konsideruar se përbën deklaram të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja "ç" e ligjit nr. 84/2016.
Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit mbetet i pambështetur në prova dhe vlerësimi i Komisionit, për sa i përket saktësisë së deklaramit të kësaj pasurie, mbetet i drejtë.
71. Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i profesionit të avokatit, në periudhën kohore 2000-2010, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
*Të ardhura nga puna si avokat nga viti 2000 deri më datë 23.11.2010, sipas dokumenteve të regjistrimit në QKR, në Degën e Tatim-Taksave Bashkia Laç dhe në DRT Lezhë, me {***}, person fizik me statusin "pasiv" që nga dita e riemërimit në detyrë si gjyqtar. Vlera 16.000.000 lekë.*
72. Në përfundim të procedurës administrative, pasi ka verifikuar deklaramet e subjektit të rivlerësimit në raport me dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime të përgjithshme mbi përlllogaritjen prej tij të shumës së deklaruar si e ardhur e realizuar nga ushtrimi i profesionit të avokatit, duke pretenduar se ajo duhet të llogaritet në masën 90% të vlerës së qarkullimit vjetor, pasi një zyrë avokatie nuk ka shpenzime të tjera, por nuk paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor provues nga autoritetet përkatëse për pretendimin e tij. Komisioni ka vlerësuar se vlera e deklaruar e qarkullimit për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore për periudhën 2000-2010, është në total në masën 13.800.000 lekë, mbështetur në dokumentacionin e administruar nga organet kompetente. Lidhur me përlllogaritjen e marzhit të fitimit neto të subjektit të rivlerësimit, nga puna e tij si avokat, nisur nga fakti se nuk ka një dokument zyrtar që konfirmon marzhin e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të subjektit për atë periudhë, Komisioni, pasi shqyrtoi edhe përgjigjet e marra nga organi kompetent tatimor, ka vlerësuar se ky marzh mund të llogaritet në masën 80% të vlerës së qarkullimit vjetor, pasi nga ai duhet të zbriten tatimet dhe taksat e paguara, detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe shpenzime për ushtrimin e aktivitetit, si: qira, shërbimet utilitare e shpenzime të tjera të nevojshme.
73. Në kundërshtim të këtij arsytimi dhe konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtitë e tij në shkakun e ankimit, të analizuar si më poshtë.
74. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marzhi i fitimit nga ushtrimi i profesionit të avokatit, i përlllogaritur nga Komisioni, nuk ka bazë ligjore dhe nuk është rezultat i një analize shkencore. Nga aktet e administruara në dosjen e rivlerësimit, provohet se gjatë periudhës 2000-2010, subjekti ka paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit, prandaj Komisioni do të duhej të pranonte fitimin neto të deklaruar nga ushtrimi i profesionit të avokatit, si një e dhënë e pandikuar nga faktorë të jashtëm, aq më tepër kur bëhet fjalë për një periudhë gjatë së cilës subjekti nuk qenë zyrtar vetëdeklarues në ILDKPKI.*
75. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton rrethanat e faktit si në vijim.

75.1 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës që i përket vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën vlerë, prej 16000.000 lekësh të ardhura nga puna si avokat për periudhën 2000-2010, siç ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

75.2 Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur si dokumentacion vërtetues të deklarimit të tij, aktet si më poshtë.

- o Dokument i lëshuar nga Bashkia Laç për z. Pashk Gjaci, profesion i lirë avokat, regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 13.03.2000.

- o Vërtetim nr. {***}, datë 14.01.2013, i Bashkisë Laç, sipas të cilit Pashk Gjaci ka kryer aktivitet privat “Avokat” me NIPT {***} dhe ka likuiduar detyrimet ndaj Bashkisë Laç: në shumën 68.700 lekë në vitin 2008, me numër licence 257; në shumën 55.900 lekë në vitin 2009, me numër licence {***} dhe në shumën 57.520 lekë në vitin 2010, me numër licence {***}.

- o Kontratë qiraje (trualli) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2000, e lidhur mes qiradhënësit, z. Gjin Trokthi, dhe qiramarrësit ,z. Pashk Gjaci, sipas së cilës qiradhënësi i ka dhënë subjektit të rivlerësimit një truall me qira 3000 lekë në muaj, për zyrë avokatie. Palët kanë rënë dakord që qiramarrësi të mos paguajë qira në shumën e përcaktuar si më sipër, derisa të plotësohet vlera preventivore e ndërtimit të lokalit, e cila është përballuar me shpenzimet e z. Pashk Gjaci, në vlerë preventivore 127000 lekë.

- o Listë emërore e të punësuarve të personit fizik Pashk Gjaci, avokat, nga ku rezulton se në vitin 2004 e 2005, bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar si sekretare pranë zyrës së tij të avokatisë.

75.3 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni rezulton se:

- o Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë (në vijim “DRT Lezhë”), me shkresën nr. {***} prot., datë 19.04.2018, ka përcjellë në Komision informacionin për personin fizik Pashk N. GJ., me aktivitet “Avokat” në Laç, sipas të cilit subjekti tatimor është regjistruar në tatime më datë 01.12.2000, aktualisht në regjistrin pasiv nga data 31.08.2012. Siç citohet në informacionin e përcjellë: “Pas verifikimit në sistemin C@TS dhe në dosjen manuale të subjektit, rezultojnë të dhënat për xhiro (qarkullim) dhe fitim i deklaruar nga subjekti:

për vitin 2000 – qarkullimi 1.000.000 lekë;
për vitin 2001 – qarkullimi 1.000.000 lekë;
për vitin 2002 – qarkullimi 1.200.000 lekë;
për vitin 2003 – qarkullimi 1.300.000 lekë;
për vitin 2004 – qarkullimi 1.000.000 lekë;
për vitin 2005 – qarkullimi 1.000.000 lekë;
për vitin 2006 – qarkullimi 1.000.000 lekë;

për vitin 2007 dhe vitin 2008 – nuk ka deklaratur;
për vitin 2009 – qarkullimi 1.700.000 lekë dhe fitimi 300.000 lekë;
për vitin 2010 – qarkullimi 0 lekë dhe fitimi 0 lekë.

Subjekti nuk ka detyrime tatimore dhe nuk ka dividendë të tërhequr.

Pas verifikimit në sistemin C@TS dhe në dosjen manuale të subjektit, rezultojnë të dhënat për kontributet shoqërore dhe shëndetësore të deklaruara dhe të paguara për vitet: 2000-2006; 2009, 2010. Për vitet 2007 dhe 2008 nuk ka vërtetim, as deklaratë.”

Bashkëlidhur shkresës, DRT Lezhë ka përcjellë dhe fotokopje të deklaratave të subjektit për qarkullimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore sipas viteve.

- o Bashkia Kurbin, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.07.2017, informon ILDKPKI-në se shtetasi Pashk N. GJ. ka ushtruar aktivitet privat “Avokat” dhe është regjistruar si tatimpagues pranë Bashkisë Kurbin, nga viti 2007 deri në vitin 2010. Ai ka deklaruar qarkullim vjetor të parashikuar për vitet ushtrimore, si vijon:

“Për vitin 2007 – deklarimi i parashikuar i qarkullimit vjetor 1.500.000 lekë; vlerësimi tatimor i taksës vendore 20.000 lekë.

Për vitin 2008 – deklarimi i parashikuar i qarkullimit vjetor 3.100.000 lekë; vlerësimi tatimor i taksës vendore 60.000 lekë.

Për vitin 2009 – deklarimi i parashikuar i qarkullimit vjetor 1.900.000 lekë; vlerësimi tatimor i taksës vendore 45.000 lekë.

Për vitin 2010 – deklarimi i parashikuar i qarkullimit vjetor 1.800.000 lekë; vlerësimi tatimor i taksës vendore 22.500 lekë (gjashtëmujori i parë).

Të gjitha detyrimet janë shlyer nga subjekti në fjalë për vitet e lartpërmendura. Përlllogaritja e fitimit ndër vite, nuk ka qenë kompetencë e institucionit tonë”.

76. Në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni për të paraqitur dokumentacion ligjor provues lidhur me vlerën totale prej 16.000.000 lekësh të qarkullimit të pretenduar si e ardhur, si dhe për të dhënë shpjegime të arsyeshme dhe bindëse lidhur me fitimin neto të realizuar nga ky aktivitet, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se fitimi i realizuar prej tij është ai i shënuar në deklaratën e rivlerësimit, por ka shpjeguar se është në mungesë të dokumenteve justifikuese, pasi ligji që normonte ushtrimin e profesionit të lirë të avokatit si biznes i vogël, nuk e detyronte ruajtjen e dokumentacionit, prej nga do të mund të llogariste saktë xhiron dhe fitimin.

Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor për të vërtetuar se fitimi i pretenduar nga ushtrimi i profesionit të avokatit ka qenë në masën 16.000.000 lekë.

77. Në shkakun e ankimit, subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konstatimit të Komisionit se *nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor për të provuar se kishte përfituar të ardhurat e pretenduara*, ka argumentuar se në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, vetëm subjektet me qarkullim mbi 5 milionë lekë kanë pasur detyrimin për dorëzimin e një deklarate vjetore tatimore, ndërsa ai nuk ka bërë pjesë në këtë kategori, duke mos qenë i detyruar të ruajë dokumente justifikuese për përlllogaritjen e fitimit neto.

Në analizë të kësaj situatë faktike në raport me argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i tij se gjithë qarkullimi i realizuar nga ushtrimi i profesionit të avokatit në periudhën kohore 2000-2010, në fakt ka përbërë fitimin ose të ardhurat e realizuara prej tij, ka mbetur në nivel deklarativ, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor nga zyrat e tatim taksave, që të vërtetojë fitimin e realizuar në vlerën e pretenduar prej 16.000.000 lekësh, duke mos përmbushur kështu detyrimin e vendosur nga neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të duhet të paraqesin të gjitha dokumentet justifikuese për vërtetësinë e deklarimeve lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Gjithashtu, udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në pikën 22, udhëzon që deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, duhet të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.

Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor për të provuar se kishte përfituar të ardhurat e pretenduara në vlerën 16.000.000 lekë nga ushtrimi i profesionit të avokatit.

78. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka asnjë dokument zyrtar që të provojë se gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit në periudhën 2000-2010, ai nuk ka paguar detyrimet ndaj shtetit, trupi gjykues vlerëson se është një pretendim jorelevant për zgjidhjen e çështjes, pasi nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi për mospagim detyrimesh tatimore ndaj shtetit.

79. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni për vitin 2009 ka përlloritur fitimin neto duke u bazuar në të dhënat e përcjella nga Bashkia Kurbin, ndërsa duhet ta përlloriste atë me të njëjtin marzh fitimi si vitet e tjera, trupi gjykues konstaton se në kundërshtim me sa pretendon subjekti, Komisioni për vitin 2009 u është referuar të dhënave të përcjella nga DRT Lezhë, të cilat raportojnë fitim të realizuar nga avokati Pashk Gjaci, vetëm për vitet 2009 dhe 2010. Trupi gjykues vlerëson se të dhënat e përcjella në Komision nga DRT Lezhë kanë vlerë provuese, sepse janë të dhënat zyrtare të organit kompetent në fushën e tatimeve, bazuar në nenin 29, pika 4 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”⁴¹. Për rrjedhojë, është i drejtë referimi i Komisionit në të dhënat zyrtare për vitin 2009, lidhur me fitimin e realizuar nga subjekti i rivlerësimit, në ushtrimin e profesionit të avokatit.
- Trupi gjykues vëren se Komisioni ka përlloritur fitimin në vlerën 270000 lekë, ndërsa sipas të dhënave të përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, fitimi i realizuar nga subjekti për vitin 2009 është 300000 lekë. Kjo e fundit është vlera e fitimit, e cila do të duhej të ishte përlloritur nga Komisioni, pasi kjo është vlera e referuar nga organi kompetent. Për pasojë, vlera 300000 lekë është vlera e fitimit që do të mbahet në konsideratë nga trupi gjykues në shqyrtimin e shkakut të ankimit që kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të financuar ndërtimin e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç.
80. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përlloraritjen nga Komisioni të qarkullimit vjetor për vitin 2010 në vlerën 0 lekë dhe përlloraritjen e fitimit në të njëjtën vlerë, duke pretenduar se ai i ka paguar detyrimet fiskale dhe ka punuar si avokat deri më datë 24.11.2010, për pasojë Komisioni duhet të kishte përlloritur një qarkullim vjetor e fitim të njëjtë me atë të vitit 2009.
- Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton se në informacionin e përcjellë në Komision nga Bashkia Kurbin, për vitin 2010, përcillen të dhëna në lidhje me qarkullimin e parashikuar nga subjekti, pra jo atë real, dhe vetëm për gjashtëmuorin e parë të vitit 2010. Për sa i përket fitimit të realizuar nga subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e profesionit të avokatit, Bashkia Kurbin nuk jep të dhëna, duke u shprehur se nuk është organi kompetent për përlloraritjen e tij.
- Në vijim të analizës së pretendimit të subjektit në raport me dokumentacionin e administruar në Komision gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues, pasi konstatoi se për sa i përket vitit 2010, DRT Lezhë, në informacionin e përcjellë në Komision, raporton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e avokatit ka realizuar qarkullim 0 lekë dhe fitim 0 lekë, i mbetet qëndrimin të mbajtur në paragrafin 79 të këtij vendimi, sipas të cilit informacioni i përcjellë në Komision nga DRT Lezhë për vitin 2010, është informacioni që ka vlerë provuese, në kuptim të të dhënave reale të qarkullimit dhe fitimit të realizuar nga subjekti i rivlerësimit, në kohën kur ushtronte profesionin e lirë të avokatit, të dhëna të cilat janë verifikuar në sistemin C@TS dhe në dosjen manuale të subjektit, sipas deklarimeve të bëra në vite nga subjekti i rivlerësimit për qarkullimin dhe fitimin e realizuar.
- Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka përlloritur drejt fitimin në vlerën 0 lekë për vitin 2010, si fitimi i realizuar nga subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e profesionit të avokatit.
- Në këto kushte, është i drejtë vlerësimi i Komisionit se fitimi i realizuar nga subjekti për vitin 2010 është në vlerën 0 lekë.

⁴¹ Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, në pikën 4 të nenit 29 parashikon: “4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon sistemin qendror të të dhënave për secilin tatimpagues”.

81. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marzhi i fitimit i përlllogaritur nga Komisioni në masën 80% nuk ka asnjë bazë ligjore dhe nuk është rezultat i një analize shkencore, pasi bazuar në përvojën e subjektit si avokat, ky marzh fitimi duhet të ishte përlllogaritur, të paktën, në masën 90-95%. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, qëndrimin e tij të kundërt me vlerësimin e Komisionit, e ka mbështetur vetëm në eksperiencën e tij si avokat, duke pretenduar se ai ka kryer shumë pak shpenzime për zyrën e avokatisë. Ky pretendim mbetet në nivel deklarativ, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se shpenzimet e kryera prej tij nuk kanë qenë në atë masë që të afektojnë negativisht fitimin e realizuar prej tij. Në kushtet kur informacioni i përcjellë nga DRT Lezhë nuk raporton të dhëna për fitim të realizuar nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2001-2008, trupi gjykues vlerëson se përlllogaritja e fitimit nga ana e Komisionit në masën 80% të vlerës së qarkullimit vjetor, është një qëndrim tejet garantist në raport me të drejtat e subjektit të rivlerësimit. Ky qëndrim konsiderohet i tillë edhe në këndvështrim të mosparaqitjes së provave nga ana e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, të cilat do të provonin ekzistencën e këtij fitimi, në vlerën e pretenduar prej tij. Trupi gjykues vëren se, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar se marzhi i fitimit të subjektit të rivlerësimit nga ushtrimi i profesionit të avokatit, mund të llogaritet në masën 80% të vlerës së qarkullimit vjetor, pasi nga ai duhet të zbriten tatimet dhe taksat e paguara, detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe shpenzime për ushtrimin e aktivitetit, si: qira, shërbimet utilitare e shpenzime të tjera të nevojshme.
82. Megjithatë, në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se marzhi i fitimit duhet të ishte përlllogaritur në një masë më të madhe nga Komisioni, trupi gjykues referuar rrethanave faktike të konstatuara në paragrafin 75 më sipër në këtë vendim, konstaton se subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e profesionit të avokatit ka kryer shpenzime për qiranë sipas kontratës së qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2000, shpenzime për pagesën e detyrimeve tatimore bazuar në informacionin e organeve tatimore qendrore e vendore, shpenzime për pagën e bashkëshortes dhe detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për të, pasi ajo ka qenë e punësuar nga subjekti në pozicionin e sekretares së zyrës avokatore. Në zërin e shpenzimeve, trupi gjykues vlerëson se duhet të përfshihen edhe shpenzimet e domosdoshme minimale për ushtrimin e aktivitetit të avokatit, si shpenzimet utilitare për ujë dhe energji elektrike, shpenzime për mjete kancelarie, si dhe materiale pastrimi. Përqindja mesatare e shpenzimeve të renditura më sipër, kundrejt qarkullimit vjetor të realizuar nga subjekti në cilësinë e avokatit, rezulton në masën 23%. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni me të drejtë ka përlllogaritur fitimin e realizuar nga subjekti në masën 80% të qarkullimit vjetor për çdo vit dhe se pretendimi i subjektit për një fitim më të lartë mbetet i paargumentuar⁴².
83. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se nuk ka paraqitur dokumente dhe nuk ka dhënë shpjegime në Komision për të provuar mundësitë financiare të vëllait të tij për të kontribuar në krijimin e pasurisë shtëpi banimi trekatëshe në Laç, pasi në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit nuk i është kërkuar nga Komisioni dokumentacion ligjor në dobi të këtij hetimi, edhe pse Komisioni kishte detyrimin ligjor t'i kalonte barrën e provës në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe të mos arrinte në përfundime pa përmbushur këtë detyrim ligjor*, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve që dokumentojnë hapat e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ,

⁴² Por edhe nëse në një qëndrim tejet garantist do të konsiderohej i mirëqenë pretendimi i subjektit se marzhi i fitimit të realizuar prej tij, është në masën 100% të qarkullimit vjetor dhe jo 80%, përsëri të ardhurat e përfituara nga subjekti nuk do të ishin në vlerën e deklaruar dhe pretenduar prej tij, 16.000.000 lekë, por do të përlllogariteshin në shumën 13.800.000 lekë, sa është qarkullimi total i kryer prej tij dhe i referuar nga organet kompetente.

Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit gjetjet në lidhje me pasurinë shtëpi banimi trekatëshe në Laç, si vijon: “Personat e tjerë të lidhur me ju, babai dhe vëllai, të cilët keni deklaruar se kanë qenë bashkë me ju, pronarë dhe investues në këtë banesë, nuk rezultojnë në asnjë nga veprimet e kryera nga leja e ndërtimit deri në regjistrimin e objektit në hipotekë. Nëse ata do të jenë bashkinvestitorë në këtë pronë, ju duhet të deklaroni pjesën e kontributit të tyre, si dhe të provoni me dokumentacion ligjor justifikues burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre. [...] Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, për sa më lart”.

84. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në mënyrë të përmbledhur: “Babai im ka dalë në pension të parakohshëm dhe ka pasur si profesion dhe specialitetin e ndërtimit. Para viteve '90 i ka siguruar të ardhurat për mirërritjen e tetë fëmijëve, përveç punës si punëtor në ndërmarrje shtetërore, duke punuar në ditë pushimi dhe jashtë orarit, në punë të dytë private, e cila ishte e ndaluar sipas ligjit të kohës. Në të tilla kushte, babai N. GJ. ka blerë truallin, ku ka ndërtuar shtëpinë njëkatëshe me sipërfaqe ndërtimi 140 m² para vitit 2002, kur unë kam aplikuar për leje ndërtimi [...]. Gjithashtu, babai ka qenë në përbërje familjare me vëllain. Të ardhurat për blerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme i ka siguruar nga puna e tij, si dhe dërgimin e tyre nga vëllai si emigrant ekonomik (shih hyrje-daljet e babait në shtetin italian nëse është e nevojshme ku ka qëndruar kohë pas kohe, ka siguruar të ardhura të tjera shpesh me punë ndërtimi etj., pra nuk qëndron arsytimi i mungesës së të ardhurave nga ana e tij). Vëllai im nga viti 1996 e deri më sot jeton në shtetin italian e punon në fushën e ndërtimit, ndërkohë që deri në fund të vitit 1999 ka drejtuar një subjekt privat “FANI” ShPK ku ka qenë administrator dhe ortak i vetëm, por duke qenë në përbërje familjare me babain, ka kontribuar në favor të tij në të gjitha aspektet. [...] Për sa u përket blerjeve dhe transaksioneve që kanë kryer babai dhe vëllai im, i qëndroj arsytimit të bërë më lart për të dy, gjithashtu në përgjigje të pyetësorit të parë kam dhënë edhe adresën e vëllait e duke qenë se jeton në një vend të Bashkimit Evropian, në Itali, mund të gjendet me lehtësi dhe ju mund të gjeni çdo të dhënë që ju nevojitet. Vëllai ka mbi 23 vjet që jeton në Itali dhe më ka ndihmuar shumë, por siç mund të keni vënë re, nuk kam referuar ndihmë tjetër përveç kontributit të tij për ndërtimin e shtëpisë në Laç”.
85. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues vëren se në kundërshtim me sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka përmbushur detyrimin ligjor për kalimin e barrës së provës tek ai, duke përmbushur detyrimin ligjor sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi në rezultatet e hetimit administrativ ka qenë i qartë në kërkesat e tij ndaj subjektit, në drejtim të provimit me dokumentacion të burimit të ligjshëm të të ardhurave, jo vetëm të vëllait, por edhe të babait të tij, për të vërtetuar deklarin e subjektit se ata kishin mundësi të kontribuonin në 1/3 pjesë për ndërtimin e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, në lidhje me burimin e krijimit të pasurive nga babai dhe vëllai i tij, ka dhënë shpjegime të cilat kanë mbetur në nivel deklarativ, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për të vërtetuar pretendimin se babai dhe vëllai i tij kanë pasur burime financiare të ligjshme për dhënie kontributi në ndërtimin e shtëpisë trekatëshe në Laç. Trupi gjykues nuk mund të qëndrojë pa vënë re se, në të kundërt të pretendimit të tij, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur një qëndrim pasiv në raport me detyrimin për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, duke i kërkuar Komisionit të gjejë çdo të dhënë që i nevojitet në lidhje me vëllanë e tij, meqenëse ai jeton në një vend të Bashkimit Evropian, në Itali. Kjo qasje pasive e subjektit të rivlerësimit ka vazhduar edhe në seancën dëgjimore të datës 19.03.2019, në të cilën ai nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor provues, si dhe nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për riçelje të hetimit administrativ, pasi relatorja e çështjes i ka vënë në dukje

se nuk ka paraqitur asnjë dokument vërtetues për të ardhurat e ligjshme të vëllait të tij si emigrant⁴³, të cilat i kanë dhënë mundësi të jepte kontributin e pretenduar në ndërtimin e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç.

Trupi gjykues vlerëson se mosparaqitja e dokumentacionit ligjor për të provuar mundësitë financiare të vëllait të tij për të kontribuar në krijimin e pasurisë shtëpi banimi trekatëshe në Laç, ka qenë një zgjedhje e subjektit të rivlerësimit, e cila duke qenë në kundërshtim me parashikimet e nenit 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, e bën pretendimin e tij të pabazuar.

86. Pretendimin se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës në lidhje me paraqitjen e dokumentacionit vërtetues për të ardhurat e ligjshme të realizuara nga vëllai i tij, trupi gjykues e konsideron si një përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të provuar pamundësinë në mosparaqitjen e këtij dokumentacioni gjatë hetimit administrativ e, për pasojë, justifikimin e paraqitjes së tij së bashku me ankimin, në përmbushje të kërkesës së nenit 47 të ligjit nr. 49/2012⁴⁴. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur akte në gjuhën italiane të Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë të provincës italiane {***} dhe {***}, në emër të vëllait të tij Gj. GJ., sipas të cilave z. Gj. ka një aktivitet individual në fushën e ndërtimit (murator) dhe të fabrikimit të dyerve dhe dritareve e riparimit të mobilieve. Këto akte nuk u pranuan në cilësinë e provës nga trupi gjykues, për arsyet e pasqyruara më sipër në paragrafët 14 dhe 15 të këtij vendimi. Megjithatë, trupi gjykues çmon të theksojë se edhe në një qëndrim tejet garantist në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për paraqitjen dhe shqyrtimin e këtyre akteve, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, ato janë të panevojshme e të parëndësishme për vendimmarrjen, pasi nga përmbajtja e tyre nuk evidentohen të dhëna në lidhje me të ardhurat e fituara nga z. Gj. GJ. në ushtrimin e aktivitetit individual. Mungesa e të dhënave për të ardhurat e realizuara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, e bën të pamundur vlerësimin nëse ai kishte burime për të investuar në masën 33% për ndërtimin e shtëpisë trekatëshe në Laç, në periudhën 2002-2007. Trupi gjykues çmon se edhe në rast se do të provohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vëllai i tij ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kontribuar në ndërtimin e banesës trekatëshe në Laç, rezultati nuk do të afektonte në zgjidhjen e çështjes, pasi në paragrafin 67 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë investitor i vetëm dhe pronar i vetëm i shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç. Trupi gjykues vlerëson të mbajë të njëjtin qëndrim edhe në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të thirrur në cilësinë e dëshmitarit, vëllanë e tij, z. Gj. GJ.
87. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka paraqitur dokumente dhe nuk ka dhënë shpjegime në Komision për të provuar mundësitë financiare të vëllait të tij për të kontribuar në krijimin e pasurisë shtëpi banimi trekatëshe në Laç, pasi Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës, nuk qëndron, pasi nuk është i bazuar në prova.
88. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare që me të ardhurat nga profesioni i lirë i avokatit të kryente një të tretën e investimit për ndërtimin e shtëpisë trekatëshe të banimit në Laç*, trupi gjykues, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit nr. 116, datë 23.03.2019, konstaton se Komisioni në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie ka arritur në konkluzionin⁴⁵ se: “Subjekti i rivlerësimit nuk mund të justifikonte me burime

⁴³ Sipas përmbajtjes së faqes 29, të procesverbalit të seancës dëgjimore, datë 19.03.2019, në Komision.

⁴⁴ Sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

⁴⁵ Sipas paragrafëve 5 dhe 12 të vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit.

të ligjshme financiare ndërtimin e kësaj pasurie në masën 100% të saj, prej tij. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, e cila rezultoi të jetë krijuar para se subjekti të bëhet gjyqtar. Kjo pasuri iu nënshtrua vlerësimit nga Komisioni pasi ishte pjesë e deklarimeve të subjektit në formularin e rivlerësimit”. Në vendim, Komisioni nuk ka referuar analizë financiare, si rezultat i së cilës ka arritur në përfundimin e cituar më sipër.

89. Në këto kushte, për të identifikuar se cilat kanë qenë përlllogaritjet e kryera nga Komisioni në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues iu drejtua akteve të hetimit administrativ të kryer në Komision, nga shqyrtimi i të cilave rezultoi se analiza financiare, e cila i është bërë e njohur subjektit të rivlerësimit, si pjesë përbërëse e rezultateve të hetimit administrativ, referon periudhën kohore 2010-2016. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se: “Duket qartë se ky objekt është blerë dhe ndërtuar tërësisht nga ju dhe, referuar analizës financiare mbi të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti juaj privat, ju nuk justifikoni burimin e ligjshëm të investimit në këtë objekt”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në mënyrë të përmbledhur, se për ndërtimin e shtëpisë së banimit, ai ka përdorur të ardhurat që fitonte nga puna si avokat. Pagesat i kanë kaluar firmës së ndërtimit rast pas rasti, sipas proceseve të punës, të cilat janë kryer me një shtrirje kohore të gjatë. Një pjesë e madhe e punimeve janë kryer nëpërmjet punës fizike të subjektit të rivlerësimit, babait dhe vëllait të tij, por subjekti nuk ka ruajtur një inventar të ndarë të këtyre punimeve. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, puna e kryer për një kohë të gjatë nga firma ndërtuese nuk është dokumentuar prej saj e aq më pak prej tij, me përjashtim të atyre dokumenteve që kërkoheshin për regjistrimin e pronës, ndërsa vlera përfundimtare e ndërtimit ka përfshirë të gjitha zërat e punimeve, si ato që ka kryer vetë firma, ato të nënkontraktuara dhe punën fizike të vetë pronarit.

Në shkakun e ankimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë punën fizike të kryer prej tij dhe babait e vëllait të tij për të ulur kostot e ndërtimit, por në përlllogaritjen e vlerës së pasurisë ka konsideruar vlerën e pasqyruar në dokumentet e regjistrimit të pronës, të cilat në fakt janë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe subjektet e kontraktuara prej tij. Në kushte të tilla, ai ka pretenduar se ka pasur mundësi financiare që me të ardhurat nga profesioni i lirë i avokatit të kryente një të tretën pjesë të investimit për ndërtimin e shtëpisë trekatëshe të banimit në Laç.

90. Në analizë të këtij pretendimi, në raport me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe rrethanat faktike të pasqyruara më sipër në paragrafin 63 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se para se të kryhet analiza financiare për vlerësimin e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duhet të zgjidhen këto çështje:

a) Sa është vlera e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç, që do të duhet të konsiderohet për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme?

b) Cila është periudha e ndërtimit të kësaj pasurie, gjatë së cilës është kryer investimi, e cila do të duhet të merret në shqyrtim për efekt të analizës financiare?

c) A është i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka kryer një të tretën e investimit për ndërtimin e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç?

91. Në lidhje me çështjen e parë, trupi gjykues vlerëson se në bazë të parashikimit të nenit Ç, pika 5 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, në këtë rast të lidhura ngushtë me vlerën që do të pranohet se ka pasuria shtëpi banimi trekatëshe në Laç. Në përmbushje të këtij detyrimi, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar se vlera e pasurisë shtëpi banimi në Laç, në momentin e regjistrimit ka qenë 11.500.000 lekë. Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi trekatëshe, të përcjellë në Komision nga ZVRPP Kurbin, pasuria është regjistruar më datë 29.12.2011, në vlerën 11.500.000 lekë, dhe është rivlerësuar në vitin 2012, në vlerën 25.260.931 lekë.

Vlera prej 11.500.000 lekësh është konsideruar nga Komisioni si vlerë e pasurisë në shqyrtimin e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të financuar ndërtimin e këtij objekti.

Subjekti i rivlerësimit, megjithëse në shkaqet e ankimit ka pretenduar se në vlerën prej 11.500.000 lekësh është përfshirë dhe puna fizike e tij, e babait dhe vëllait të tij, prandaj kostoja e ndërtimit ka qenë më e ulët, nuk ka shpjeguar se sa konkretisht është vlera e punës fizike e pretenduar prej tij dhe sa duhet të ishte vlera e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç, që Komisioni duhet të kishte mbajtur në konsideratë në vlerësimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pranon se kjo është një vlerë e deklaruar prej vetë atij në ZVRPP, që ka dhënë pasojë juridike dhe nuk është kontestuar për pavlefshmëri, por nuk ka shpjeguar se nëse kostoja e ndërtimit ka qenë më e ulët, pse ai ka deklaruar në momentin e regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme vlerën prej 11.500.000 lekësh.

Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se vlera e shtëpisë së banimit trekatëshe në Laç, është vlera prej 11.500.000 lekësh, e rezultuar nga të dhënat e kartelës për regjistrimin e pasurisë në ZVRPP Kurbin. Trupi gjykues në këtë vlerësim mban në konsideratë edhe faktin se kjo është vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën para fillimit të detyrës, e dorëzuar në ILDKPKI më datë 24.12.2010, rreth një vit përpara regjistrimit të pasurisë në fjalë në regjistrin e pasurive të paluajtshme, deklarim i cili rezulton të jetë i njëjtë me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke provuar vërtetësinë e këtij të fundit, referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues mbajti në konsideratë këtë vlerë në analizën financiare për vlerësimin e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të krijuar pasurinë shtëpi banimi trekatëshe në Laç.

92. Për sa i përket periudhës së ndërtimit të kësaj shtëpie, trupi gjykues konstaton se Komisioni në analizën financiare të kryer për efekt të rezultateve të hetimit administrativ, ka konsideruar periudhën 2007-2011 si periudhë të krijimit të pasurisë.

Në verifikim të situatës faktike, me qëllim përcaktimin e periudhës së krijimit të kësaj pasurie, në raport me vlerësimin e bërë nga Komisioni, sipas akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe akteve të përcjella nga ZVRPP Kurbin gjatë hetimit administrativ, siç janë pasqyruar në paragrafin 63 të këtij vendimi, trupi gjykues vëren se data e fillimit të punimeve të ndërtimit të shtëpisë trekatëshe të banimit, është data 10.01.2003, ndërsa data e përfundimit të punimeve është 10.12.2007.

Gjatë hetimit administrativ në Komision⁴⁶, në përgjigje të pyetjes së Komisionit: “A ka pësuar shtëpia juaj ndryshime apo përmirësime të pronës (ndërtime/rikonstruksione) të jashtme apo të brendshme, nëse po, cila ka qenë kostoja e shpenzimeve?” – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Banesa ime nga pamja e jashtme vlerësohet e përfunduar, por në fakt akoma nuk mund të konsiderohet e përfunduar, nuk ka pasur asnjë rikonstruksion tjetër pas vitit 2007, megjithëse duket se ka ardhur koha për të kryer riparime, që shpresoj të kryhen në të ardhmen”.

Në një analizë harmonike të deklaratave të mësipërme të subjektit të rivlerësimit me të dhënat e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues në të kundërt të Komisionit, arrin në përfundimin se periudha e krijimit të pasurisë, në kuptim të kryerjes së shpenzimeve për ndërtimin e saj, është periudha 2003-2007. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2010, nuk ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri, por në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ ka deklaruar se për ndërtimin e shtëpisë së banimit, ai ka përdorur të ardhurat që fitonte nga puna si avokat, trupi gjykues, për të garantuar një gjykim sa më të drejtë, vlerësoi të shtrijë analizën financiare në periudhën 01.03.2000 - 31.12.2007, pasi më datë 13.03.2000⁴⁷, subjekti i rivlerësimit ka filluar të ushtrojë profesionin e avokatit, ndërsa në fund të vitit 2007 kanë përfunduar punimet e ndërtimit për pasurinë shtëpi banimi në Laç. Të ardhurat e fituara nga subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e funksionit të avokatit do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerën 7.200.000 lekë, duke i përlloritur ato si të ardhurat totale të periudhës 2000-2007, në masën 80% të qarkullimit vjetor të realizuar në secilin vit nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në arsyetimin e bërë nga trupi gjykues në paragrafin 82 të këtij vendimi.

93. Në lidhje me çështjen e tretë, se a është i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka kryer një të tretën e investimit në këtë pasuri, trupi gjykues çmon të theksojë se i mbetet konkluzionit të arritur më sipër, në paragrafin 67 të këtij vendimi, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka qenë investitori i vetëm në ndërtimin e shtëpisë së banimit në Laç.

Trupi gjykues çmon të theksojë se edhe në një analizë tejet garantiste të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, rezulton se pretendimi i tij se ka kryer një të tretën e investimit në kuptim të shpenzimeve të kryera për ndërtimin e saj, nuk qëndron. Në aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.01.2012, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit, babait dhe vëllait të tij, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “Unë N. Gj. kam qenë pronar i truallit mbi të cilin është ndërtuar kjo shtëpi banimi, ndërsa financiarisht për ndërtimin e kësaj banese kanë kontribuar në pjesë të barabarta të dy djemtë e mi”. Nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se edhe nëse do të rezultonte e vërtetë se shpenzimet financiare për ndërtimin e shtëpisë janë përballuar nga disa investitorë, pjesa e kontributit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit do të ishte një e dya dhe jo një e treta, siç pretendon ai.

⁴⁶ Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit mbi pyetësoin e dytë të drejtuar nga Komisioni.

⁴⁷ Sipas dokumentit të lëshuar nga Bashkia Laç për z. Pashk Gjaci, profesion i lirë avokat, regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 13.03.2000.

94. Trupi gjykues, në funksion të konkluzioneve të arritura për secilën prej çështjeve të shtruara për zgjidhje si më sipër, kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e subjektit për të përballuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e pasurisë shtëpi banimi, me tri kate, në Laç. Referuar rezultatit të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit shtëpi banimi në Laç, në vlerën 11.754.259 lekë. Edhe nëse analiza financiare do të kryhej në një qëndrim tejet garantist, duke ndjekur pretendimet e subjektit të rivlerësimit, rezulton përsëri se ai ka mungesë të burimeve të ligjshme për ndërtimin e objektit shtëpi banimi në Laç, në vlerën 4.087.589 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë së tij, shtëpi banimi trekatëshe në Laç, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit mbetet i paargumentuar dhe i pabazuar.
95. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në shkaqet e ankimit, parashtrimet e paraqitura prej tij, para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, si dhe të gjitha provat e aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, arriti në përfundimin se vendimi nr. 116, datë 21.03.2019, i Komisionit është i drejtë, bazuar në konkluzionet si vijojnë, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:
1. Për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3800 m², në fshatin {***}, Velipojë, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaramit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me pjesën zotëruese të saj, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
 2. Për pasurinë shtëpi banimi trekatëshe në lagjen nr. 2, Laç, subjekti i rivlerësimit:
 - a) është në kushtet e deklaramit të rremë në lidhje me burimin e krijimit dhe sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016;
 - b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
96. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha akteve e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit, bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Pashk Gjaci ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
97. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, vlerëson se vendimi nr. 116, datë 21.03.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 116, datë 21.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Pashk Gjaci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.07.2020.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

RELATORE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina Rama

nënshkrimi